Da tempo, in questa città sono iniziati gli eventi culturali e artistici in onore del millenario di San Nilo. Ci sono state presentazioni di libri scientifici, filosofici, religiosi, romanzi, sculture, pitture, temi archeologici e storici, feste tradizionali, ecc. Grazie a questo programma ricco e significativo, la vita a Grottaferrata è rinviata: i giovani non vanno più nelle città vicine per divertirsi, il numero di turisti è aumentato, i commercianti sono soddisfatti poiché, grazie a queste iniziative promosse dal Comune, hanno visto crescere i loro interessi. Ma ciò che è più importante è che il Monastero di San Nilo sta superando i confini dell'interesse globale, attirando numerosi visitatori da tutto il mondo, cosa che non si vedeva da decenni. Dobbiamo sentirci fortunati ad avere tra noi una delle ricchezze più rare e preziose, il nostro millenario Monastero, che considero un pantheon per noi grottaferratesi e oltre. I primi a comprendere questo tesoro sono stati proprio il Sindaco Di Bernardo e la sua squadra. Se si dà uno sguardo al programma stilato dal Comune per questo millenario, si nota un programma ricco di attività che trasmettono cultura e civiltà, dove



Abbazia di Santa Maria Gaspar Van Wittel dip. (sec. XVIII)

domina soprattutto l'equazione più importante: far conoscere questo luogo sacro e di grande valore a livello globale. E se Grottaferrata deve essere una destinazione per migliaia e migliaia di turisti in futuro, bisogna guidarla con volontà, coerenza, amore e cultura. Questo sembra essere l'obiettivo principale del Comune e del suo Sindaco, evidente in ogni progetto e intervento che viene realizzato con qualità, professionalità e cultura, affinché le future generazioni siano felici di ciò che stiamo facendo oggi. Soprattutto, il Monastero di San Nilo, come ponte tra Oriente e Occidente, deve essere un forte punto di riferimento per tutti. È il momento di lavorare insieme per rafforzare l'armonia tra di noi e dare al Comune e al suo Sindaco ciò che meritano, come recita l'antica frase latina: dare a Cesare ciò che è di Cesare.

Grottaferrata principessa e Kasteli Romanit e më gjerë

Kushdo mund të pyesë pse një titull i tillë! Megjithatë, kjo është një realitet, pa hyrë në bindje politike, por që ekziston dhe është i dukshëm për sytë e qytetarëve dhe të qindra vizitorëve që kanë ardhur në këtë qytet të vogël, jo larg Romës antike. Gjatë dy viteve të fundit, ai po ndryshon çdo muaj, çdo ditë, çdo orë dhe çdo minutë. Ky qytet, me një program të detajuar nga ekipi qeverisës i Komunës, i drejtuar nga brilanti Prof. Mirko Di Bernardo, po i nënshtrohet një transformimi të plotë, një ndryshimi rrënjësor nën moton "Për qytetarët dhe për Grottaferratën", sepse gjithçka që bëjmë është në harmoni me bukuritë që Nëna Natyrë i ka dhuruar këtij qyteti, në dobi të të gjithë qytetarëve të tij.

Një udhëtim nëpër Grottaferrata

Për të vëzhguar dhe shijuar realitetin e këtij qyteti, ndërmorëm një udhëtim nëpër Grottaferrata me një grup banorësh rezident, por të ardhur nga rajone të tjera të Italisë, si Puglia, Marche, Sicilia, Piemonte, Calabria, Sardegna, Toscana, Basilicata, etj. Lagjet, rrugët dhe sheqet, si në periferi ashtu edhe në qendër, kanë ndryshuar: syri has në kantierë operativë për të respektuar afatet e realizimit të projekteve. Rrugët janë asfaltuar si kurrë më parë, trotualet janë të cilësish së lartë, hapësira të lira për qytetarët dhe fëmijët, kopshte të mbushura me gjelbërim, ku qytetarët kalojnë kohën duke lexuar një libër apo një gazetë... gjithçka që shih syri ka një fjalë kyçe të shkruar me shkronja të mëdha: "Faleminderit Kryetar dhe ekip qeverisës për atë që po bëni për Grottaferratën dhe qytetarët e saj."

Shën Nilo dhe mijëvjeçari i tij

Ne arbëreshët kemi një motiv të fortë dhe të detajuar për të qenë të pranishëm në këtë mijëvjeçar, sepse prej shekujsh priftërinjtë arbëreshë kanë dhënë një kontribut të çmuar, jo vetëm në albanologji duke na lënë vepra të jashtëzakonshme, që përfaqësojnë një thesar të rrallë për historiografinë arbëreshe, por edhe sepse pikërisht nga ky vend i shenjtë, në vitin 1640 dhe në vitet pasuese, u nisën murgjtë bazilianë në mision drejt Shqipërisë. Këta murgj na kanë lënë dorëshkrime, kanë hapur shkolla të gjuhës shqipe në Himarë, Dhërmi dhe në vende të tjera, për të cilat ne arbëreshët duhet të jemi përjetësisht mirënjohës.

Prej kohësh, në këtë qytet kanë filluar aktivitetet kulturore dhe artistike në nder të mijëvjeçarit të Shën Nilos. Ka pasur prezantime librash shkencorë, filozofikë, fetarë, romane, skulptura, piktura, tema arkeologjike dhe historike, festa tradicionale, etj. Falë këtij programi të pasur dhe domethënës, jeta në Grottaferrata është rigjallëruar: të rinjtë nuk shkojnë më në qytetet e afërta për t'u argëtuar, numri i turistëve është rritur, tregtarët janë të kënaqur sepse, falë këtyre nismave të promovuara nga Komuna, kanë parë një rritje të interesave të tyre. Por më e rëndësishmja është që Manastiri i Shën Nilos po tejkalon kufijtë e interesit global, duke tërhequr një numër të madh vizitorësh nga e gjithë bota, gjë që nuk shihej prej dekadash. Duhet të ndihemi me fat që kemi mes nesh një nga pasuritë më të rralla dhe më të çmuara, manastirin tonë mijëvjeçar, që e konsideroj një panteon për ne grottaferratasit dhe përtej. Të parët që e kanë kuptuar këtë thesar kanë qenë pikërisht Kryetari Di Bernardo dhe ekipi i tij. Nëse i hedhim një sy programit të hartuar nga Komuna për këtë mijëvjeçar, vihet re një program i pasur me aktivitete që përcjellin kulturë dhe qytetërim, ku dominon mbi të gjitha ekuacioni më i rëndësishëm: të njohim këtë vend të shenjtë dhe me vlerë të madhe në nivel global. Dhe nëse Grottaferrata duhet të jetë një destinacion për mijëra e mijëra turistë në të ardhmen, ajo duhet udhëhequr me vullnet, koherencë, dashuri dhe kulturë. Kjo duket të jetë synimi kryesor i Komunës dhe Kryetarit të saj, i dukshëm në çdo projekt dhe ndërhyrje që realizohet me cilësi, profesionalizëm dhe kulturë, në mënyrë që brezat e ardhshëm të jenë të lumtur për atë që po bëjmë sot. Mbi të gjitha, Manastiri i Shën Nilos, si urë mes Lindjes dhe Perëndimit, duhet të jetë një pikë referimi e fortë për të gjithë. Është koha të punojmë së bashku për të forcuar harmoninë mes nesh dhe për t'i dhënë Komunës dhe Kryetarit të saj atë që meritojnë, siç thotë shprehja e vjetër latine: t'i japësh Cezarit atë që është e Cezarit.

Lamtumirë Nikollaq Doraci!

"Të dashur atdhetarë dhe bashkëpunëtorë të gazetës.

Me dhimbje ju njoftoj se nga trangu i gazetës u shkëput një degë e fortë e prodhimitare ..., u largua në përjetësi një mik, shok, bashkëpunëtor i zellshëm, fjalëpak dhe mbështetës i heshtur i gazetës qysh në daljen e saj, me origjinë nga Vlora, i paharruari Nikollaq Doraci.



Redaksia e gazetës Rrënjët ju shpreh ngushëllimet më të ndjera familjes. Amen!"

"Cari compatrioti e collaboratori del giornale,



Con dolore vi informo che dal trango del giornale si è staccato un ramo forte e produttivo..., è passato all'eternità un amico, compagno, collaboratore zelante, di poche parole e silenzioso sostenitore del nostro giornale, originario di Valona, l'indimenticabile Nikollaq Doraci.

La redazione del giornale esprime le sue più sincere condoglianze alla famiglia. Amen!"



12 qershori i vitit 1999 ose dita kur filloi ndryshimi i madh

Nga Imer Xhemail Lladrovci - Gjermani

Pas 12 qershorit të vitit 1999 ndryshoi gjithçka në Kosovë. I pari ndryshim i madh është mungesa e policisë dhe ushtrisë serbe në këtë vend, çlirimi i shqiptarëve prej një makthi të madh.

Pak histori. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në perëndim dhe në lindje të Shqipërisë londineze u pushtuan nga Serbia në dy Luftërat Ballkanike të viteve 1912 e 1913. Këto luftëra erdhën si rrjedhojë e faktit se Porta e Lartë e ndryshoi politikën e saj ndaj Arnautllëkut, ajo u bë më shpirtgjërë, duke e pranuar shtetin autonom shqiptar brenda Perandorisë Osmane. Kush nuk e kupton Ismail Qemajl Vlorën kur flet për këtë shtet autonom shqiptar, duhet të dijë diçka për backgroundin e tij. Edhe Perandoria Osmane bënte diplomaci, ndoshta nuk e kishte me gjithë mend shtetin autonom shqiptar, por ky qëndrim i Stambollit pragmatik e irritoi Moskën ideologjike, Beogradin dhe Athinën e babëzitur shumë, ato ishin në gjendje të pranonin zgjidhjet paqësore, por jo zgjidhje të tilla që e minonin gjeopolitikën e Moskës dhe ambicinet territoriale të tokave shqiptare në Turqinë europiane të Beogradit dhe Athinës. Kështu erdhi te Lufta e Parë Ballkanike dhe te Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Diçka vërtet duhej bërë, paçka se gjithçka bëhej mbrapsht. Shekulli i XX po fillonte për ne me një tragjedi të madhe kombëtare: Copëtimin e Shqipërisë. Paqja e Europës thonin se varet nga fati politik i Shqipërisë.

Për ruajtjen e saj tani e tutje duhej të flitej për Shqipërinë si koncept gjeografik dhe jo për Shqipërinë si realitet kombëtar. Asgjësimi i saj shestohej në kokat e diplomatëve të botës, të cilët përhapnin me vetëdije të plotë iluzionin se kështu po e shpëtonin botën nga një katastrofë e madhe e luftës. Kështu po flitjehej një komb i lashtë për kinse paqen e kontinentit të vjetër, një popull që në njëfarë mënyre qëndronte në themelet e tij. Dukej si vrasje, por në të vërtetë ishte një vetëvrasje. Legjenda e Kështjellës së Shkodrës, tani me përmbajtje politike, po trokiste edhe një herë tjetër në portat tona. Po bëhej një lojë e ndyrë diplomatike mes të mëdhenjëve që nuk mirreshin vesh dot sesi ta sundonin këtë botë jallane. Rusia e madhe, në sytë e diplomatëve të saj, nuk ishte mjaftueshëm e madhe. Për më tepër ajo donte ngrohtësi. Në veriun e saj të ftohtë nuk ndjehej rehat. Shqipëria e vogël, në anën tjetër, nuk ishte mjaft e vogël, ajo duhej të bëhej edhe më e vogël, derisa të kthehej në një provincë muslimane në Shqipërinë qendrore.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913 e coptoi Shqipërinë pa fije mëshire, por e keqja ende nuk kishte marrë fund. Ishte keq, por mund të bëhej edhe më keq. E mira ishte struktur në zemrat e njerëzve. Nuk duhej të dilte që andej, nëse donte të ekzistonte në këtë kaos të madh që vriste gjithçka fisnike. Në ndërkohë kemi mësuar se ishte përgatitur dhe nënshkruar edhe një marrëveshje shumë më e keqe se ajo e dy viteve më parë, marrëveshja e fshehtë e Konferencës së dytë të Ambasadorëve në Londër, ajo e vitit 1915 që e „korrigjonte“ Konferencën e vitit 1913 në kuptimin që Shqipëria të tkurrej në një provincë muslimane me Durrësin si port të vetëm në Adriatik dhe Esad Pashë Toptanin në krye. „Korrigjimet“ nuk u vunë



në jetë kurrë ndër të tjera, edhe sepse njëri nga shtetet që insistoi në to, tashmë nuk ekzistonte: Kishte rënë nga skena politike e botës Perandoria Ruse e carit. Bashkimi Sovjetik që i zuri vendin këtij supershteti, në fillim, u bë sikur hoqi dorë nga ambicinet imperiale të carit, por shpejt e ndryshoi kursin e saj në politikën ndërkombëtare, duke i rikthyer ëndërrave të vjetra për Romën e Katërt, edhe pse haptazi kurrë s'e zuri në gojë. Ajo që nuk duket e nuk thuhet shpesh është më e rëndësishmja në jetë. Dhe, sidomos, në politikë.

As Lufta e Dytë Botërore nuk i solli fat Shqipërisë dhe shqiptarëve. Përkundrazi, një tjetër fatkeqësi të madhe ideologjike që në parim çdo kundërshtar të saj e linte pa varr. Ndarja e saj në Londër në vitin 1913 mbetej edhe më tej në fuqi. Shaban Polluzha deshi të ndryshojë diçka, por u shtyp me gjak kryengritja e tij. Ishte tepër herët për ta bërë më të mirë këtë botë që ishte tërbuar nga infektimi ideologjik. Greqia dhe Jugosllavia, përkatësisht Serbia vazhdonin të komplotonin kundër Shqipërisë. Jugosllavia dhe Greqia kishin orientime të ndryshme në ideologjinë politike, por ato i bashkonte urrejtja për kombin shqiptar. Shqipëria vërtet ishte e vogël, por edhe si e tillë pengonte, ndaj dhe duhej zhbërë krejt përmes ndarjes jugosllavo-greke. Por Kosova, në ndërkohë, nuk e gjente dot qetësinë e saj me Serbinë mbi krye. Ajo e fitoi universitetin dhe autonominë politike në saj të mbështetjes së administratës amerikane të presidentit Riçard Nikson (Richard Nixon) dhe sekretarit të tij gjenial të shtetit Henri Kisingjer (Henry Kissinger). Natyrisht dukja ishte krejt tjetër në fund të viteve 1960 e në fillim të atyre 1970. Atëbotë shumçka nuk dihej ose ekzistonte një perceptim i çoroditur ideologjik i realitetit politik.

Në vitin 1981, pa u bërë viti nga vdekja e presidentit të përjetshëm Josip Broz Tito, shpërthyen demonstratat studentore dhe mbarëpopullore shqiptare, ku ndër të tjera u kërkua edhe Republika e Kosovës. Ende nuk është zbrëthyer enigma e

organizimit të tyre. Atëbotë kishte plotë shqiptarë të zgjuar, që s'bënin gjë, por spekulonin se e gjitha ishte një lojë e ngatërruar ruse. Që diçka e madhe po mbruhej në zemrën e Kosovës, për këtë nuk dyshonte askush. Në fillim kjo republikë projektohej në mendjen e njerëzve si një entitet federal, por në vitet 1990 shqiptarët hap pas hapi ndryshuan mendje.

Në fakt qëllimi i të gjitha organizatave ilegale shqiptare kishte qenë gjithmonë një Kosovë me viset e saj jashtë Serbisë e Jugosllavisë. Ajo që dikur kishte qenë bashkë duhej të ribashkohej. Kështu e donte logjike e natyrës së gjërave. Qarqet atdhetare kurrë nuk e kishin fjetur mendjen. Të organizuara si grupe ilegale, ato kishin punuar fshehtas dhe hapur për një atdhe të lirë shqiptar. Por për një Kosovë si shtet i pavarur në atë kohë askund nuk bëhej fjalë. Megjithatë, në vitet e vona 1990 gjithnjë e më shumë nisi të flitej për një shtet kosovar si subjekt ndërkombëtar. Në kushtet e reja bashkimi kishte ndërruar formë.

Por shtetet nuk bëhen kurrë vetëm me fjalë. Bërja e shtetit është një gjë tepër e madhe, e ndërlikuar dhe, asnjëherë, një dëshirë e përkorë. Në vitin 1996 doli në skenën Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Ishte e armatosur keq në fillim, por vullnetin dhe vendosmërinë për luftë kundër pushtuesit serb e kishte të madhe sikundër edhe mbështetjen në popull. Jetën e donte secili, por Serbia nuk lejonte jetë tjetër, pos asaj të robit. Kështu politika paqësore e dr. Rugovës po ia lëshonte vendin një politike tjetër: Politikës që bëhej përmes armëve dhe luftës së armatosur. As Sllovenia, as Kroacia e Bosnja më vonë nuk ishin bërë shtete më vete pa luftë. Pse duhej atëherë Kosova të bënte përjashtimin këtu?! Diçka që është marrë me luftë rrallë ndodh të lëshohet pa luftë, sidomos kur ke iluzionin se ke një ushtri të fortë dhe të gatshme për të vrrarë secilin që i delë përpara.

Dr. Rugova gjithnjë e më tepër kërkonte ndërhyrjen e NATO-s, mirëpo NATO-ja nuk ishte një organizatë bamirëse. Si

organizatë e fuqishme ushtarake, ajo mund të ndërhynte aty ku kishte luftë dhe ku kërcënohej ndonjë katastrofë humanitare. Kosova ishte një vatër potenciale lufte, por aty ende mbretëronte qetësia: Shqiptarët ç'është e vërteta ishin tmerrësisht të palumtur e të shtypur, por ata nuk ngrinin krye: Duronin. Një masakër e madhe i kërcënohej popullit shqiptar në këtë krahinë jugore serbe, siç quhej ajo në shtypin evropian, por jo për aq kohë sa shqiptarët pasivë të ishin pjesë e poshtërimit të tyre. Me paraqitjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjithçka ndryshoi. Shqiptarët e dikurshëm, që e pranonin nënshtrimin, tani u rebeluan, u hodhën në luftë. Serbia reagoi në mënyrën e saj gjakatare. Por Adem Jashari dhe familja e fisi i tij s'u përkulën. Masakra që pritej ndodhi. Ajo u përsërit edhe shumë herë të tjera anembanë Kosovës. Serbia nuk ndalej para asnjë krimi: Vriste foshnja e fëmijë, gra dhe pleq. Civilët ishin në fokusin e formacioneve të armatosura shtetërore. Kështu ndodhi edhe në Reçak në janar të vitit 1999. Erdhi Konferenca e Rambujesë (Rambouillet), si një përpjekje idealiste për të shmangur luftën, por serbët e shpërfillën këtë shans.

Me 24 mars u ngritën avionët e parë të NATO-s nga baza e tyre në Aviano të Italisë. Filloi Lufta Ajrore kundër Jugosllavisë-Serbisë e Malit të Zi. Me 9 qershor në Kumanovë Millosheviqi (Milošević) u dorëzua, e nënshkroi kapitullimin e tij. Tre ditë më vonë, më 12 qershor 1999, trupat tokësore të NATO-s se bashku me ushtaret e UÇK së marrshuan nëpër qytetet e Kosovës. Kjo ditë e madhe e ndryshoi gjithë historinë tonë kombëtare. 12 qershori i 1999 e solli me 17 shkurt 2008 shtetin që quhet Republika e Kosovës, të cilin ne nuk mund ta ruajmë e zhvillojmë, nëse mohojmë apo nuk e njohim historinë e tij.

Autori është ish diplomat karriere dhe shefi Konsullatës së Kosovës në Stuttgart dhe Vjenë të Austrisë.

GLI STUDI ALBANOLOGICI DI RAJKO NAHTIGAL

Di Peter Štoka - Slovenia

Sono noti i meriti di Nahtigal nella revisione della grammatica albanese di Pekmezi *Grammatik der albanesischen Sprache* (1908), così come il suo atteggiamento nei confronti della lingua letteraria unificata, che corrispondeva alla decisione della Commissione letteraria; ma fu ancora più importante che ha saputo conciliare la situazione storico-linguistica albanese con la situazione linguistica contemporanea sul campo.

“Infine, va sottolineato che l'autore è stato aiutato dal dott. fil. Rajko Nachtigall con parole e fatti in molti modi, dal momento che è stato così gentile da condividere alcuni dei risultati dei suoi studi albanologici e osservazioni sulla lingua viva, ad es. sull'accento albanese, ecc., che vorrebbe comparisse al più presto per la gioia degli studi albanesi. Molte grazie al mio caro amico!” (Dr. Pekmezi)

La sua opera si inserisce in una tradizione slovena di interesse per la cultura albanese, che include pionieri come Bartolomeo Kopitar e Fran Miklošič, i quali si occuparono dell'albanese all'interno delle ricerche balcaniche e pre-indoeuropee. Nahtigal divenne una figura di spicco all'inizio del XX secolo, quando, nel 1916-17, fu incaricato dalla Commissione Letteraria Albanese di aiutare a risolvere il problema della standardizzazione della lingua letteraria albanese.

Il problema principale riguardava la scelta tra le due principali varianti dialettali, Gegh e Tosk. La Commissione, guidata da Pekmezi, scartò l'idea di creare un linguaggio “artificiale” che mescolasse elementi di entrambe le varianti e optò per il dialetto di Elbasan, considerato un ponte linguistico tra Gegh e Tosk. Nahtigal, dopo un viaggio di studio in Albania, redasse un Memorandum intitolato *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache* (Graz, 1917), in cui sostenne l'importanza di scegliere il dialetto di Elbasan come base per la lingua comune albanese. Questo dialetto, sebbene appartenente alla variante Gegh, aveva caratteristiche che potevano favorire l'unificazione linguistica.

Nahtigal cita il famoso detto “*Shqipja e Elbasanit, turcja*



Da sinistra a destra: Rajko Nahtigal, Presidente dell'Accademia di scienze e Rettore dell'Università di Lubiana; seduto P.Ndre Mjeda; e Gjergj Pekmezi, compagno di studi con Nahtigal a Graz in Austria.

e *Stambollit*”, che significa più o meno lo stesso di lingua toscana e bocca romana. Ma molte volte diverse ortografie offuscavano l'immagine uniforme della lingua. Nahtigal evidenzia particolarmente la posizione centrale di Elbasan e il suo dialetto; situato sulle rive del fiume Shkumbi, gli abitanti si considerano Geghi, ma già quelli sulla sponda meridionale si ritengono Toski. In zona si mescolano pure i costumi nazionali: i Toski di Berat influenzano Elbasan, e il costume dei Geghi nelle vicinanze di Elbasan si diffonde verso i Toski a sud. Ma ancora più importanti sono i fenomeni linguistici: spostandoci dal dialetto tosco del sud verso i geghi del nord possiamo seguire lo sviluppo storico della lingua albanese. Tutti questi fatti da soli dettano la scelta della base per la lingua letteraria.

Nahtigal evidenzia come il dialetto di Elbasan fosse rimasto meno influenzato da elementi esterni e possedesse un forte valore sintattico e morfologico, conservando testimonianze scritte di autori illustri.

Oltre alla vasta raccolta lessicale di A. Xhuvani e alla raccolta di tesori popolari di Lef Nosi, il dialetto di Elbasan ha avuto in passato due importanti personalità letterarie che conserveranno un posto permanente nella storia letteraria e linguistica albanese: Theodor Haxhifilipi, conosciuto come Maestro o Dhaskall Todhri e Konstandin Kristoforidhi. Quest'ultimo, in particolare, fu una figura centrale nella letteratura albanese, noto per le sue traduzioni della Bibbia e per il suo stile linguistico che risultava comprensibile a tutta la popolazione albanese. Nahtigal sostenne che il lavoro di Kristoforidhi potesse costituire una base solida per una grammatica e un dizionario albanese moderni. Nel 1923, Nahtigal tornò sull'argomento con uno studio sulla singolare scrittura di Elbasan, attribuendone l'origine a Todhri e chiarendo che si trattava di un sistema stilizzato basato sull'alfabeto greco, non su quello fenicio come precedentemente ipotizzato.

Sebbene Nahtigal abbia poi rivolto i suoi studi principalmente alla slavistica, il suo contributo all'albanologia, soprattutto nella definizione delle basi della lingua letteraria albanese, è stato di grande rilievo e resta ancora oggi apprezzato.

IKONAT E DIÇO ZOGRAFIT NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

Nga Andrea Llukani - Tiranë

Muzeu Historik Kombëtar si institucioni më i madh o memories kombëtare në bashkëpunim me Muzeun e Artit Mesjetar, Korçë dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Korçë në kuadër të Ditëve Europiane të Trashëgimisë dhe Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore çelën ekspozitën me titull “Ikonat e Diço Zografit në Muzeun Historik Kombëtar”. Ekspozita përbëhej 20 stenda, të cilat përmbanin fotografi të ikonave të ikonografit Diço Zografi, duke përfshirë edhe “Dyert e Bukura” të ikonostasit të kishës së Shën Kollit në Elbasan.

Në ceremoninë e hapjes të ekspozitës përshëndeti përfaqësuesja e Muzeut Historik Kombëtar, znj. Elsjona Kote, si dhe Drejtor i Muzeut të Artit Mesjetar Korçë znj. Fioralba Priifti. Gjithashtu, u mbajtën dy referate me temë: “Ikonat e Diço Zografit në Muzeun Historik Kombëtar”, nga z. Andre Llukani, nga Muzeu Historik Kombëtar, dhe referati me temë: “Trashëgimia kulturore në rajonin tonë”, nga dr. Metin Venxhi, Përgjegjës i Departamentit të Historisë dhe Gjeografisë, Universiteti “Fan Noli”. Folësit theksuan rëndësinë e Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, duke vlerësuar veprën e ikonografit maqedonas Diço Zografit në artin ikonografik shqiptar.

Cili ishte piktori ikonograf Diço Zografi

Piktori ikonograf Diço Zografi e ka ushtruar aktivitetin e tij në Maqedoni, Bullgari dhe në Serbi. Diço e mësoi artin e ikonografisë prej mësuesve të tij, Mihal dhe Dhimitër Anagnostit gjatë kohës që kanë punuar së bashku në manastirin e Bigorskit. Diço Zografi në vitin 1853 ka pikturuar ka pikturuar ikonat e kishës së Shën Gjergjit në Vërnice të Gollobordës. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që ka lënë në ikonën e Shën Mërisë: “Me dorën e Diço Zografit, nga katundi Tresance, 1853, muaji dhjetor 4”. Mbishkrimi është shkruar me alfabetin cirilik, ndërsa për datën ka përdorur greqishten bizantine.

Në vitin 1855 Diço Zografi ka pikturuar ikonat e ikonostasit të kishës së Shën Kollit në Elbasan. Diço Zografi ka pasur dy djem Abrahamin dhe Spiridhonin, të cilëve u mësoi artin e ikonografisë. Djali i madh, Abrahami ka pikturuar shumë kisha, por nuk e kishte talentin e të atit, ndërsa Spiridhoni vdiq herët. E veçanta e Diço Zografit është sepse ai pothuajse në çdo ikonë ka lënë nënshkrimin

e tij. Përkushtimet e donatorëve të ikonave ai i shkruante sllavisht ose në greqishten bizantine, sipas porosive. Ai ka qenë ikonografi më i shquar i kohës në Maqedoni. Porositësit prisnin me vite të tëra për të pasur një ikonë të pikturuar prej Diço Zografit. Tematika e ikonave të pikturuara prej tij është e larmishme. Aktivitetin kryesor e ka zhvilluar në fshatin Tresonik, ku gjendej atelieja e tij.

Sipas programit për kartelizimin dhe studimin shkencor të materialit që gjendet në fondin e Muzeut Historik Kombëtar, gjatë hulumtimit u gjetën tre ikona të mëdha, të cilat mendohet se janë pikturuar nga Diço Zografi: Ikona e Shën Kollit, ikona

e Shën Harallambit, si edhe ikona e Shën Athanasit. Këto ikona i përkasin kishës së Shën Kollit në Elbasan. Në fundin e ikonës së Shën Athanasit Diço Zografi ka lënë mbishkrimin dygjuhësh në greqishten bizantine dhe në sllavishte: *διά χειρός δήτζου ζωγράφου έκ επαρχίας Δεβρων*, 1855. “Me dorën e Diço Zografit nga zona e Dhevron, 1855”.

Sipas programit për kartelizimin të materialit që gjendet në fondin e Muzeut Historik Kombëtar, gjatë hulumtimit u gjetën edhe disa ikona të vogla, që i përkasin kishës së Shën Kollit në Elbasan.

Ndër ikonat e vogla mund të përmendim ikona shenjtorësh: Shën Stefani; Apostull Jakovi; Tre Jerarkët; Teodor Tironi dhe Teodor Stratilati. Kemi ikona nga cikli i festave: Zënia e Shën Anës; Lindja e Pagëzorit; Gratë Mirapurrëse; Pendikostia; Krishtlindja; E diela e Thomait; Zënia e Pagëzorit; Etj. Gjithashtu, Dyert e bukura të ikonostasit të kishës së Shën Kollit në Elbasan, aktualisht gjenden në pavijonin e ikonave të Muzeut Historik Kombëtar. Gdhendësi i Dyerve të bukura nuk dihet, por ato janë pikturuar nga Diço Zografi në vitin 1859.

Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që Diço Zografi ka lënë në Dyert e bukura të ikonostasit: *Διά χειρός δήτζου ζ*, 1859, “Me dorën e Diço Z, 1859”. Në kulmin e Dyerve të bukura Diço Zografi ka pikturuar Krishtin Pandokrator. Në pjesën ballore të Dyerve të bukura Diço Zografi ka pikturuar Kryeengjellin Gabriel dhe përballë tij Shën Mërinë. Ndërsa në pjesën fundore të dyerve ai ka pikturuar Shën Vasilin, Shën Joan Gojëartin, Shën Grigor Teologun dhe Shën Nikollën.

Historiku i kishës së Shën Kollit, Elbasan

Kisha e Shën Kollit në Elbasan mendohet të jetë ndërtuar rreth vitit 1700. Vite më vonë ajo është djegur dhe është meremetuar në vitin 1849. Ky fakt vërtetohet nga fermani i Sulltan Mexhiti drejtuar Prefektit të Prefekturës së Ohrit, Haxhi Fahir Beut dhe dijetarëve Naib Kadiut të kazasë së Elbasanit.

Nga fermani mësojmë përmasat që ka pasur kisha: 39 metra e gjatë, 28 metra e gjatë dhe 13 metra e lartë. Kisha ka pasur dy dyer si edhe gjashtë dritare. Sipas fermanit Sulltan Mexhiti i drejtohej Prefektit të Prefekturës së Ohrit, Haxhi Fahir Beut, që kisha të rindërtohej sipas përmasave që ka pasur. Kisha e Shën Kollit në Elbasan në vitin 1980 u prish nga themelet dhe në truallin e saj u ndërtua një pallat banimi. Kisha është rindërtuar pas viteve 90-të.



PSE ASOMATI NUK E ASIMILOI DOT KRAHËBARDHËN?



Nga **ALJOSHA KORKAJ** – Firenze

Velça përbën një unikum të rrallë tek sa ruajti me fanatizëm dhe transmetoi gojë më gojë që nga gjeneza e brezave radhë, emërtimet e lashta. Dhe më tipiku është toponimi “krahëbardha”, e cila sot është tkurrur në një sipërfaqe disa hektarëshe, dhe që ka patur kuptimin hyjnor: “Ëngjëll me flatra të bardha, qenie shpirtërore të padukshme e të mbinatyrshme që fluturojnë në mbretërinë e qiellit mbështetur mbi dy krahë”. E kështu me radhë “lajmëtar i perëndisë, sinonim i dritës apo agut të ditës (zbardhëllimit), bardhësisë së shpirtit” etj. Referuar fakteve (gërmimeve arkeologjike të ky toponim, viti 2015), besimtarët pagan të Velçës e kishin konceptuar dhe praktikuar përfytyrimin dhe simbolin e ëngjëjve afro 1000 vjet më parë se pushtuesit sllavë të mbivendosnin këtu simbolin e tyre Asomatit.

Këtë e dëshmon jo vetëm emërtimi i kësaj zone me simbolin e ëngjëjve (Krahëbardha), por dhe ekzistenca e vetë tempullit pagan (shek. I – III), të cilin pushtuesit e kthyen në rrënoja. Përbrenda kësaj zone ndodhet dhe emërtimi Maja e Qytetit, në të cilën duhet të ketë patur rezidencën prijësi, familjarët dhe trungu fisnor i tij. Maja e Qytetit dhe vetë Qyteti (siç quhej rëndomtë asokohe qendra e hershme e banimit), e cila shtrihet në lagjet Gërmadha, Selita, Bregu i Drizave, Koshtra, Lugu i Mullirit, dëshmojnë një zhvillim të pa kontestueshëm të kësaj zone në lashtësi.

Ç’ka na lë të nënkuptojmë se, Krahëbardha dhe tempulli pagan i saj ishte në funksionin shpirtëror të këtij ish Qytetit. Emërtim tjetër i Velçës që simbolizonte “ëngjëllin” ishte dhe Shpella e Mëngjillit, pasi “mëngjilli = m’ëngjilli = ëngj (ëngjëll) + i(y)lli = ylli ëngjëll”, Ai që lajmëron ardhjen e Dritës - zbardhjen e Ditës dhe Diellit. Të dyja këto toponime hyjnore ndodhen në një distancë afro 2 km largësi midis tyre.

Studiuesit thonë: “...që vetë figuracionet e ëngjëjve, fillimisht, janë marrë hua nga kultura e Lindjes së afërme, shek. VI para Krishtit, konkretisht nga Palestina. Prej tyre (hebraishtes) më pas e huazuan edhe grekët (agjello) dhe latinët (angelus)...”

Por çndodhi? Mbasi pushtuan Vlorën dhe zonën e Lumit (viti 904), mbretëritë bullgare që lidhen me Shën Klementin e Ohrit, përmbi themelet e tempullit pagan të Krahëbardhës ndërtuan kultin e tyre, Kishën e Asomatit. Kështu që, detyrimisht, edhe vetë zona prej qindra hektarësh ndërroi emërtimin, nga Krahëbardha u quajt fusha e Asomatit.

Përreth simbolit “asomati” kam shkruar edhe herë tjetër, por detyrohem ta përsërit të ky shkrim për të specifikuar edhe një fakt të ri.

Në një shkrim të “Shqiptarja. com”, e datës 3 Tetor 2015, gjatë një interviste, arkeologu Skënder Muça, duke folur për gërmimet të Kisha e Asomatit në Velçë sqaron: “... Emërtimi “asomati” është një mbivendosje prej mbretërive pushtuese bullgare (shek.

IX), që lidhen me Shën Klementin e Ohrit... është një territor i gjerë që e ka përdorur Asomatit dhe se ky emër vjen nga greqishtja kishtare: “ασώματα = i pa trup”, por që ka edhe kuptimin “shpirtrat ose ëngjëjt që nuk ekzistojnë”!

Te bazamenti i kësaj kishe ishte një tempull pagan, i pa identifikuar, muret e të cilit i takojnë periudhës shek. I - III, kthyer në rrënoja dhe, përmbi to, në shek. 9 – të, është hedhur themeli i kishës së Asomatit. Të dhënat datojnë që kjo kishë lidhet me periudhën e aktivitetit të Shën Klementit të Ohrit, peshkop i Velikës...Deri në këtë periudhë, te ky territor Shën Mëhilli dhe Shën Gabrieli nuk njiheshin, por njihej Shën Asomati...”

E për ta sqaruar më saktë këtë simbol (Asomati) të besimit sllav (bullgar & Peshkopata e Ohrit), i cili në shek. IX u mbivendos në Velçë, më vjen në ndihmë libri i Fatbardha Demit “Mrekullia e Mbijetesës”, f.40, ku shkruhet:

“Studiuesja e filozofisë H. Blavatsky, duke folur për emërtimin AIN Soph në Bibël, pohon se sipas filozofit Filone i Aleksandrisë (v.20 – 45 p.K. Quaestiones et Solutiones in Genesis), AIN Soft, është “Zoti i Dytë dhe Mençuria e tij”, është një Hyjni që simbolizon “ASGJË”, është e pa – emër, prandaj dhe quhet “Ain Soph” sepse fjala “Ain” do të thotë “ASGJË” dhe në gjuhën ebraike, AIN simbolizon atë që nuk ekziston”. Pra, kuptimi simbolik “asomati = i pa – trup, apo shpirtrat e ëngjëjt që nuk ek-

zistojnë” është një paralelizëm (apo huazim) i simbolit hebraik “AIN”. Sllavët e huazuan nga helenët, të cilët nga ana e tyre e huazuan nga ebraishtja! Të interpretosh sfidën: pse Krahëbardha i rezistoi asimilimit e zhdukjes nga Asomati, qoftë si emërtim apo si simbol, kjo lidhet me disa arsye të veçanta siç shprehen në përgjithësi studiuesit e fushës: “Gjithçka, edhe në origjinë, emrat ishin të lidhura me mendimin mitiko – religjioz... Origjina hyjnore dhe lidhja me paraardhësit e lashtë, shprehej nëpërmjet simboleve...Përmes emërtimeve të toponimeve ata përjetësonin mbi tokë hyjnitë e veta...Ishte populli (te ky rast banorët vendas) që i aplikonin ato rite pasi e kishin trashëguar prej të parëve... Te emërtimet e vjetra shikojmë se ata kishin një civilizim të vetin kulturor e religjioz të trashëguar...”

Sa herë shkoj në Velçë kthehem te Krahëbardha. Një rikthim me pak gëzim, nga që tempulli original pagan është shkatërruar. Gjithsesi, mbijetesja e Krahëbardhës në ato vite të trishta ku shumë emërtime dhe rite u asimiluan nga mbivendosjet e pushtuesve sllavë, mbetet një dëshmi kolosale e besimit të zhdukur.

Këto “nishane” të kujtesës pagane u përcollën në rrjedhën e shekujve gojarisht si për të lidhur brezin e sotëm me tre elementë: dëshminë hyjnore, gjuhësore dhe historike. Po e përmend jo si kuriozitet, por fakt, që Toponim me emërimin Krahëbardha ndodhet dhe zona të varrezat e fshatit Mesaplik,

NJË THESAR QË MBETI I PANJOHUR PËR 95 VITE

Nga Kujtim Mateli - Tiranë


Në tre shekujt e fundit, shumë dijetarë evropianë, popullsinë e parë që banonte në trojet ku banojnë sot grekët, pra pellazgët, i kanë lidhur me shqiptarët. Kjo për arsyen se vetë helenët e antikitetit kanë shkruar se, kur erdhën në këto troje, gjetëm atë popullsi që quhej pellazge. Herodoti thotë: "helenët emrat e perëndive i morën nga pellazgët". Që do të thotë se kjo popullsi ndodhej në një nivel më të lartë se popullsitë e ardhura që filluan ta banonin këtë territor. Madje ata shkruajnë për qytetet dhe qytetërimin e tyre, i përshkruajnë si luftëtarë, mikpritës dhe me shpirt të madh dhe bujar.

Kjo tezë evropiane tre shekujt e origjinës së shqiptarëve nga pellazgët u përqafua nga Rilindja jonë Kombëtare. Ata përcaktuan gjuhën dhe historinë si dy elementët bazë mbi të cilat do të ngrihej identiteti ynë kombëtar, prandaj ata e nisën punën plot vull dhe energji për të vërtetuar lashtësinë e gjuhës shqipe dhe prejardhjen e tyre nga pellazgët që kishte shenjuar me Dodonën një pikë kulmore në historinë e njerëzimit. Studimet e tyre në kërkim të së vërtetës ndeshnin me ligësinë e fqinjëve dhe shpifjet e tyre se shqiptarët janë të ardhur shumë vonë në trojet ku banojnë sot dhe se nuk kishin një gjuhë të tyre, prandaj fuqitë evropiane nuk mund t'i merrnin në konsideratë për të formuar një komb shqiptar.

Rilindasit do të merrnin përgjegjësinë për t'iu përgjigjur këtyre shpifjeve dhe të thelloheshin, aq sa i mundësonte koha, në fushë të historisë dhe gjuhësisë. Ata do ta përcaktonin origjinën e shqiptarëve nga ajo popullsi e quajtur pellazge dhe gjuhën e tyre do ta quanin hyjnore, si gjuha që lindi perënditë dhe u dha atyre emrat me të cilat i njohim sot. Kjo luftë e armiqve tanë nuk u ndërpre as pas Shpalljes së Pavarësisë. Në vazhdim të këtyre përpjekjeve titanike të dijetarëve shqiptarë për të vërtetuar origjinën tonë pellazgjike dhe gjuhën shqipe si gjuhën që emërtoi hyjnitë pellazge, është edhe studiuesi, gati i panjohur për shqiptarët, Leonida Ndrenika, i cili e botoi librin e tij studimor në italisht "I pelasgi e la loro lingua" (Pellazgët dhe gjuha e tyre), në Napoli, më 12 shtator 1929. Siç thotë vetë autori, këtë libër e shkroi në italisht për të arritur kuptueshmëri më të madhe në botën shkencore ndërkombëtare. Për jetën e tij dimë pak: është nga Vunoj, fshat i cili bën pjesë në bashkinë e Himarës. Do të duheshin 95 vite, që ky libër të njihet nga shqiptarët falë përkushtimit të znj. Fetije Picari, e cila e solli këtë libër në të dy gjuhët: italisht dhe në shqip. Përkthyesja Fetije Picari, bashkë me të palodhurin dhe botuesin e gazetës "Rrënjët" (që botohet italisht dhe shqip) z. Hasan Alija, kanë kontribut të çmuar në njohjen e vlerave të identitetit tonë kombëtar edhe në shtetin italian ku kemi një komunitet të madh shqiptarësh.

Libri studimor, "Pellazgët dhe gjuha e tyre" tregon se Leonida Ndrenika kishte njohuri të plota në fushë të historisë dhe gjuhësisë. Libri është ndërtuar në vërtetimin e tezës se shqiptarët rrjedhin nga ajo popullsi që quhej pellazge. Për këtë ka sjellë në libër të gjithë autorët e antikitetit që kanë shkruar për pellazgët, territorin në të cilin ata ishin vendosur, emigrimet e tyre në Azinë e Vogël, por sidomos në Itali. Në vërtetim të tezës se shqiptarët janë pasardhës të pellazgëve ka shfrytëzuar shumë emra të përveçëm njerëzish dhe emra vendesh, që autorët e antikitetit, duke filluar me Homerin dhe Hesiodin e deri te Straboni dhe Pausania, i lidhin me pellazgët. Dodonës, kryeqytetit të pellazgëve, autori i ka kushtuar vëmendje të veçantë, duke sjellë për lexuesit thëniet e autorëve të antikitetit që e lidhin Dodonën me Epirin pellazg, kurse raportet me Helladën janë ato që fqinjët formojnë me njëri-tjetrin.

Autori i këtij studimi Leonida Ndrenika, ka shfrytëzuar në vërtetim të tezës që shqiptarët rrjedhin nga pellazgët edhe një numër të konsiderueshëm të autorëve modernë, të cilët mendonin se gjuha shqipe rrjedh nga mijëvjeçarët e shkuar dhe është folur para gjuhës greke dhe



asaj latine, para çdo gjuhe tjetër që ne njohim apo ka mbetur nga antikiteti. Kështu Malte-Brun do të shkruante: "Gjuha shqipe nuk ndryshon rëndësisht nga gjuha më e vjetër e pellazgëve, në fakt ajo është e përafërt me të." (Leonida Ndrenika "Pellazgët dhe gjuha e tyre" Tiranë 2024, faqe 5)

Autori i këtij studimi, sjell albanologun e shquar Von Han, i cili pat shkruar: "Proto-shqiptari është jo vetëm një bashkëkohës i proto-romakut dhe proto-grekut, por ka midis tyre një afritet, një ngjashmëri. Me fjalë të tjera, ato çfarë janë të ngjashme midis dy popujve burojnë nga i njëjti element pellazgjik." (Po aty faqe 6)

Nëse ka diçka të përbashkët midis shqiptarëve, romakëve dhe grekëve, nuk është vendodhja pranë njëri-tjetrit, por elementi pellazgjik që ka depërtuar te të dy popujt: romakët dhe grekët. Ky është përfundimi i dijetarit Von Han, i cili ka dalë nga një realitet historik, përderisa helenët dhe latinët i ngritën qytetërimet e tyre mbi atë territor ku më parë kishin banuar pellazgët. Vatra më e rëndësishme e pellazgëve ka qenë Epiri, aty ku Dodona krijoi qytetërimin e parë dhe ndezi dritën në lindjen e dy qytetërimeve të mëvonshme: atij helen dhe romak. Këtë na e thonë autorët e antikitetit që fiset e Epirit i konsideronin pellazge dhe po ashtu pellazge quanin dhe kryeqytetin e tyre Dodonën. Autori i këtij studimi Leonida Ndrenika, i ka konsideruar autorët e antikitetit si burime të dorës së parë: "Hesiodi, edhe ky autokton, flet për pellazgët dhe përmend Dodonën në shkrimet e tij dhe nëjloj si shumë shkrimtarë të tjerë i kanë konsideruar të gjitha fiset e Epirit si pellazge. (Straboni l. V, 220)" (Po aty faqe 7)

Autorët e antikitetit kanë sjellë prova për përkatësinë pellazge të banorëve të Epirit, madje edhe maqedonasit nga autorët e antikitetit janë konsideruar fise pellazge. Për këtë i drejtohet Strabonit duke e cituar: "Straboni më tej pohon se epirotët dhe maqedonasit përdornin të njëjtën gjuhë dhe të njëjtat zakone, visheshin njëjloj dhe qethnin flokët në të njëjtën mënyrë. (33)" (po aty faqe 14)

Autori sjell një numër të konsiderueshëm fjalësh që janë përdorur nga autorët e antikitetit, të cilët nuk i lidhnin me helenët, por me gjuhën barbare të epirotëve dhe maqedonasve. Nga kjo vërtetohet që epirotët flisnin një gjuhë që ishte e ndryshme nga helenët dhe në analizë të këtyre fjalëve arrin në përfundimin se gjuha e banorëve pellazgë të Epirit ka qenë gjuha shqipe.

"Fjalët e gjuhës pellazgjike që mbijetojnë në monumentet e antikitetit klasik, janë fjalë të gjuhës shqipe që vazhdojnë me kuptimin që kishin në ato kohëra: vende që historia e lashtë i përshkruante vendbanime të pellazgëve dhe shumë prej tyre që kishin emra, janë fjalë shqipe, janë ende të banuara në numër të madh nga kombi ynë." (po aty faqe 16)

Autori përmend historianët romakë që vërtetonin se pellazgët kishin shkuar në Itali disa breza para Luftës së Trojës nga Akea, e cila nënkuptonte Greqinë e lashtë pellazgjike. Dësh-

mi të tjera vërtetojnë se edhe banorët e Lacio ishin pellazgë duke përmendur Plinin, i cili thotë se shkronjat e alfabetit i sollën në Lacio pellazgët dhe më tej vazhdon: "...tradita të tjera dëshmojnë se edhe emri i Romës ishte pellazg dhe i lidhin me saturnalët, me një festë me origjinë pellazge që kishte nisur në malin Saturn. ...Pellazgët sipas Niebuhr, ishin popullsia origjinale jo vetëm e Greqisë, por edhe e Italisë." (po aty faqe 22)

Nëse helenët deri në kohën e Strabonit shtriheshin në jug të gjirit të Ambracisë dhe të Magnezisë, pra në jug të Epirit dhe të Thesalisë, kjo pjesë e mbetur e Pellazgisë ndodhej jashtë ndikimit helen. Autori i studimit Leonida Ndrenika, mbështetur te autorët e antikitetit tregon për një lidhje të ngushtë të banorëve të Italisë me banorët e Epirit dhe të Thesalisë. Kjo lidhje nuk është vetëm me jugun e Italisë, por shtrihet deri në veri të saj: "Legjenda të tjera vendosin në lidhje të ngushtë umbrianët, peucetët dhe fise të tjera të veriut të Italisë dhe bregut adriatik me pellazgët e Epirit dhe Thesalisë." (Po aty faqe 21)



Ne kete foto familjare dhe e vetmja qe gjetem ne arkivin e familjes Ndrenika.

I ulur babai i Robert Anagnosti Ndrenika me dy motrat dhe ne kembe vellai i tij Leonida Anagnosti Ndrenika.

Kjo dëshmi tregon se Epiri dhe Thesalia pellazge i ruajtën lidhjet me të parët e tyre që u hodhën në Itali. Provë e sigurt kjo se Epiri pellazg nuk ka lidhje me helenët, por i përket asaj etnie që sot përfaqësohet nga shqiptarët që banojnë në jugun e Shqipërisë.

Autori mundohet të përcaktojë gjuhën e pellazgëve dhe, duke u mbështetur në mendimin e disa autorëve të mëparshëm, del në përfundimin se gjuha pellazge nuk kishte lidhje me gjuhën helenë, e cila për ta konsiderohej si gjuhë barbare: "Gjuha e tyre e ashpër është më afër latinishtes se sa greqishtes, u ruajt në dialektin eolik dhe në dialektin e Epirit, të konsideruar

barbar nga helenët." (po aty faqe 25)

Autori shtrirjen e pellazgëve në një territor të gjerë e vërteton me emrat pellazgë në këto territore ku veçojmë: "në Azi, në Thesali, në Itali gjejmë qytetin pellazgjik të Larisës." (po aty faqe 27)

Autori arrin në përfundime të rëndësishme për pellazgët dhe për shqiptarët si pasardhës të tyre, duke u mbështetur te autorët e antikitetit që janë burimi parësor për çdo kërkues shkencor, por edhe te autorët e tjerë të kohës së tij që i kanë parë shqiptarët si pasardhës të pellazgëve, të cilët kanë lënë gjurmët e tyre në botën greko-latine. Autori ka sjellë 66 burime nga autorët më të rëndësishëm që kanë shkruar për pellazgët, shtrirjen gjeografike dhe gjuhën e tyre Ato janë burime bazë që mund të përdoren edhe nga kërkuesit e sotëm shkencorë. Autori përmend një numër të konsiderueshëm autorësh dhe duke u mbështetur në përfundimet e tyre shkruan: "që gjuha shqipe është ajo e pellazgëve e dëshmojnë edhe von Hahn, A. Schleicher, Otto Blau, Thomopulo dhe të tjerë." (po aty faqe 35)

Për të vërtetuar që shqipja e ka origjinën nga gjuha pellazge, ka sjellë në analizë etimologjike një numër të madh fjalësh që i gjejmë te autorët e antikitetit, por që janë ende në vendet ku banojnë sot shqiptarët duke treguar në këtë mënyrë vazhdimësinë nga pellazgët te shqiptarët. Në vëmendjen e autorit, nuk mund të anashkalohej kryeqyteti i pellazgëve që ishte Dodona, e cila ndriçoi me qytetërimin e saj jo vetëm etninë pellazge, por edhe në botën helenë dhe atë latine, të cilët morën prej saj jo vetëm sistemin e besimit, emrat e hyjnive dhe mitologjinë, por edhe mënyrën e jetesës që u vu në themelet e qytetërimit të tyre.

Që Dodona dhe qytetërimi i saj nuk ka lidhje me helenët, autori sjell si dëshmi faktin që Dorimahu i Etolisë e shkatërroi Dodonën në vitin 219 para Krishtit, sepse fama e saj i kishte hijezuar faltoret helene. Nëse Dodona do të kishte qenë helene, ata do të krenoheshin me të dhe nuk do të ndërmerrnin veprimin barbar të shkatërrimit të saj.

Dodona dhe qytetërimi pellazgjik erdhën deri në ditët e sotme, sepse një periudhë e tërë historike mban emrin e tyre, fakt të cilin e thekson edhe enciklopedia italiane: "Traditat më të besueshme të pellazgëve, të shpërndara në rrënojat parahistorike në territorin e Greqisë, në plazhet dhe ishujt e detit Egje, gjithashtu dhe në Azinë e Vogël, por edhe në Itali, gjenden në kujtimet e poetëve, historianëve dhe gjeografëve të antikitetit klasik." (po aty faqe 6-7)

Në mbyllje të librit, autori ka sjellë një fjalor trigjuhësh: shqip, greqisht, latinisht. Rëndësia e tij qëndron në vërtetimin e faktit se shqipja ka qëndruar krahas tyre dhe në shumë raste mund të jetë burim i parë prej nga kanë rrjedhur fjalët për dy gjuhët e tjera.

Përfundim:

Për tezën e origjinës së shqiptarëve nga pellazgët kanë punuar një numër i madh dijetarësh shqiptarë dhe të huaj, në një shtrirje kohore mbi 300 vjeçare. Kjo tezë mbetet e papranuar plotësisht deri në ditët e sotme, megjithëse secili brez dijetarësh ka sjellë prova të mjaftueshme në vërtetim të saj. Në këtë kontribut të çmuar renditet edhe emri i Leonida Ndrenikës. Pellazgët janë një popull me histori dhe qytetërim që kanë shenjuar emrin e tyre në histori me kryeqytetin e tyre që ishte Dodona prej nga rrjedhin dy qytetërimet e tjera ai helen dhe romak, siç e pranojnë vetë disa nga dijetarët që kanë folur dhe shkruar për pellazgët. Mohimi që i bëjnë institucionet tona shkencore origjinës sonë pellazgjike, e rrudh dimensionin kohor të origjinës sonë dhe njëkohësisht vlerat e qytetërimit të tyre që qëndrojnë në themelet e qytetërimeve të mëvonshme. Ndaj përkushtimi i këtyre dhjetra dijetarëve që kanë punuar për historinë e kombit tonë duke hulumtuar nëpër biblioteka, duke shfletuar mijëra libra, duhet vlerësuar dhe duhet të vendosen denjësisht në panteonin e njerëzve të shquar që kanë dhënë kontribute madhore në zbardhjen e identitetit tonë kombëtar.

Një takim mbresëlënës, një surprizë e dyfishtë

Nga **Fitije Picari** – Ravenna

Sllavishtja për këtë fjalë nga ç'ka kam përfunduar është ndërtuar nga shqipja dhe në kohën që është formuar duhet të kishte simbolikën tjetër nga shqipja në formën «Zër i zë' (ZRIZ), jo «vër i ge' (VeRIG), (vër një G), jo me G-ë por me Z-ë, e cila ka përfunduar si «coceд'/sused/zused/ZAIED/(nga kuptimi primordial i shqipes i shqipes NGJITUR, Z>S', B>D-T)[sused] njesoj si fjala protosllave grurë ne zrit (g>z)

Sllavishtja ka huazuar dhe adaptuar format dhe kuptimet «Z'ë» të shqipes më së shumti, dhe jo të «G»-së.

*Ngjit e shqipes shpjegon «gjiton», «susedi», «komshije», dhe G>S>Z shpjegojnë

format e tjera.

Nuk është pa arsye ndodhja e fjalës në anglisht su «NEIGHBOR» (N'G bër'/ një G-bër.

«Vër një G', ose «bër një G' është simbolika e gjuhës shqipe për fjalën «verige». Cila gjuhë i ka keto fjalë? Asnje gjuhë.

Si e shpjegojnë origjinën e «verige» pro-sllavishtet?

Trashëguar nga proto-balto-sllavishtja *wér'tei, dhe thonë ndoshta nga proto-indo-evropianja *hzer-.

Sllavishtja sipas gjuhëtareve ideologjike mund të ketë trashëguar dy forma sinkronike nga e njëjta rrënjë:

*verti

Me kuptimin për të shtyrë, për të nxitur

Sinonimet: *paxati, *sovati.

Çlidhje semantika ka «shtyrja, nxitja» me

grurin?

Kush gjuhëtar mund ta pranohet këtë llogjikë etimologjike?

*Verti nuk ka lidhjen më të vogël semantike me *verige të shqipes.

«verigë» f (shumës veriga, shquar veriga, shumësi i caktuar verigat), hallka e një zinxhiri,

po nga shqipja ku z>g.

Analizoni vetem te ngjashmet e gjuhës shqipe për të kuptuar origjinën si varg, vargor, vargua, kunj druri ose hekuri që lidh zgjedhën (lidhje G), vjegë, vesh, gath, rezhdë, lak (lag-lidh) vjegëz (njisoj si veshi që lidhet me kokën, lidhje VG). Me siguri vetëm te paguarit nga ideoetimologjia mund të arrijnë në të tilla përfundime allogjike, pa lidhje më të vogël semantike dhe simbolike.

Gjuha shqipe: Zbulimi i Kodit Primordial

Trojet e lashta të arbanëve (Arbios, shqiptarët) ishin të parat që përhapën grurin në botë, pasuar nga qytetërimi dhe gjuha e tyre. Kjo trashëgimi pasqyrohet në etimologjinë e «GRURË» (gruri), duke shpalosur një simbolikë të thellë. Simbolizmi i G: Bashkimi dhe Rritja, Shkronja G përfaqëson bashkimin e farave, ndërsa L simbolizon rritjen, duke qëndruar drejt si një lule. Ky model është i qëndrueshëm në fjalët shqipe:

1. VARG (në rresht) - lidhje, unitet
2. GARDH (gardh) - mbrojtje, rrethim
3. HARDHI (nga halgi) - rritje, bollëk

4. VERIGE (zinxhiri i rrrushit) - ndërldhje.

5. GJIS (Ngjitës) - lidhje, unitet

6. GJITON (FQINJ) - ngjitur, lidhur

Supozime gjuhësore sfiduese

Gjuhëtarët shpesh ia atribuojnë fjalën «verige» (fqinj) origjinës sllave. Megjithatë, një shqyrtim më i afërt zbulon se gjuhët sllave e kanë huazuar këtë fjalë nga shqipja. Gjuhës sllave i mungon thellësia simbolike e G-së, e cila gjendet në mënyrë unike në shqipen, greqishten e vjetër dhe anglishten.

Analiza etimologjike

Fjala sllave «verige» (fqinj) e ka origjinën nga shqipja «vër i g'». Ky dallim zbulon kodet primitive të shqipes, të errësuar qëllimisht nga manipulimi gjuhësor.

Simbolizmi i G në anglisht

Fjala angleze «gather» (gadhër) i bën jehonë G-së simbolike të shqipes, që përfaqëson bashkimin dhe koleksionin. Po kështu, «GUR» (GUR), «GRURË» (GRURI) dhe «GJË» (GJË) demonstrojnë gjuhën e qëndrueshme simbolike të shqipes.

Huaja dhe përshtatja sllave

Gjuhët sllave huazuan dhe përshtatën fjalët shqipe, duke zëvendësuar G-në me Z.

Fshehja e origjinës së gjuhës së parë.

Ndryshimi i qëllimshëm i strukturës simbolike të shqipes synonte të fshihte epërsinë dhe lidhjen e gjuhës me hyjnoren.

Përfundim:

Gjuha shqipe mban çelësin për të kuptuar rrënjët simbolike të qytetërimit njerëzor. Etimologjia dhe simbolika e saj unike zbulojnë:

1. Shqipja si protogjuhë, me ndikim në gjuhët fqinje.

2. Origjina hyjnore e gjuhës, që lidh të gjitha gjuhët me një burim të vetëm.

Implikimet

1. Rivlerësimi i historisë gjuhësore dhe shkëmbimit kulturor.

2. Njohja e rolit kryesor të shqipes në formësimin e gjuhës dhe simbolizmit njerëzor.

E kanë sulmuar shqipen pikërisht në kodet primordiale të saj, për të fshehur gjetjen e origjinës së gjuhës së parë dhe simbolikën e saj. Kjo është thjesht gjuha e ZOTIT, nga një origjinë e parë e vetme vinë të gjitha, dhe ajo origjinë është gjuha shqipe.

Referencat

«Gruri» në Ilo Stefanllari, Fjalor praktik shqip (1996)

^ An Albanian Historical Grammar, Stuart E. Mann, Buske, 1977, f.55

Quentin Atkinson në Universitetin e Auckland në Zelandën e Re.

(Shkenca 24 gusht 2012: Vol. 337 nr. 6097 fq. 957-960 DOI: 10.1126/science.1219669).

[https://www.science.org/doi/full/10.1126/scienc.abg0818](https://www.science.org/doi/full/10.1126/science.abg0818)

https://en.m.wiktionary.org/wiki/%D0%B7%D1%80%D1%8C%D0%BD%D0%BE#Old_Church_Slavonic

«verigë/a», në FGJSSH: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe [Fjalori i gjuhës së sotme shqipe][1] (në shqip), 1980, faqe 2134f.

^ Orel, Vladimir E. (1998) «stone», in Albanian Etymological Dictionary, Leiden, Boston, Köln: Brill, →ISBN, page 127

Ylli, Xhelal (1997) «verigë», në Das slavische Lehngut im Albanischen (Slavistische Beiträge: 350)[2], vëllimi 1. Lehnwörter, Mynih: Otto Sagner, faqe 276b

Svane, Gunnar (1992) Slavische Lehnwörter im Albanischen (Acta Iutlandica. Humanistische Reihe; 67) (në gjermanisht), Aarhus: Aarhus University Press, →ISBN, faqe 86f.

Mann, S. E. (1948) «verig-ë», në An Historical Albanian-English Dictionary, London: Longmans, Green & Co., faqe 551a

«verigë-a», në Edukata e Ré. Revistë pedagogjike (shqip), numër 1, Tiranë: Gutenberg, 1930, faqe 37b.

Leotti, Angelo (1916) «verig-a», në L'albanese parlato (në italisht), Milano: U. Hoepli, faqe 182.

Weigand, Gustav (1914) «verig-a», në Albanesisches-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch (në gjermanisht), Leipzig: J. A. Barth, faqe 98b

Kristoforidhi, Kostandin (1904) «βερύγ-α», në Λεξικόν της Ἀλβανικής γλώσσης [Lexikon tës Albanikës glóssēs] (në greqisht), Athinë, faqe 22.

Meyer, G. (1891) «verige», në Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache [Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe] (në gjermanisht), Strassburg: Karl J. Trübner, →DOI, faqe 466

Orel, Vladimir E. (1998) «verigë», në Fjalorin Etimologjik Shqiptar, Leiden, Boston, Köln: Brill, →ISBN, faqe 500

Në gjuhën turke ka shumë fjalë të shqipes së lashtë

Nga Asqeri Diko – Stamboll

Gjatë 5 shekujsh të sundimit osman, shqiptarët në trojet e tyre, në kushte jashtëzakonisht të vështira, mundën ta ruajnë me shumë kujdes, maturi e logjikë shqiptare, identitetin e tyre etnik, gjuhësor dhe kulturor si popull, në një kohë që ende nuk ishin formuar si një komb i veçantë. Popujt e Ballkanit, nuk kanë pasur kurrë lidhje të drejtpërdrejta, me arabët apo popullin pers. Gjithësesi, ata kanë jetuar 500 vjet me osmanët, një kohë shumë e gjatë. Kjo kohë, sigurisht, do të sillte ndryshime të shumta në përdorimin e gjuhëve në Gadishullin Ilirik që sot gabimisht quhet Ballkan në ndikimin e pasur gjuhësor. Konkretisht, kultura osmane ka gjurmët e veta në Shqipëri dhe kjo lidhet me historinë tonë. Duam apo nuk duam në shqiptarët, ndikimet osmane kanë tashmë pjesë në trashëgiminë tonë: në vlera, zakone, tradita, besime, në kulturën materiale, në folklor, art, muzikë, veshje, arkitekturë dhe mënyra jetese. Ajo ishte gjuha e marrdhënieve e lidhjeve, e komunikimeve brendapërbrenda Perandorisë Osmane për ballkanasit. Ndikimi i kulturës osmane në Shqipëri, është më i madh se çfarëdo lloj ndikimi tjetër, për vetë faktin se Shqipëria ka qenë për 500 vjet, pjesë e një mozaiku kulturor osman. Ndryshe ndodhi me popullin e Greqisë, i cili u shkëput nga kjo Perandori, në vitin 1821. Në Greqi, ndikimi i gjuhës osmane, që më pak se në gjuhët e tjera në Ballkan.

Fjala turke, i është përshtatur gradualisht gjatë këtyre shekujve, gjuhëve të Ballkanit e më gjerë. Fjalori osmano - turk, përdorej në disa fusha të jetës së popujve ballkanas, si në: jetën e përditshme, në administratë, në letërsi: poezi a prozë, në gjuhën a ritet fetare, në hartimin e teksteve shkollore, etj. Turqishtja, që përbëhej dhe përbëhet edhe sot e kësaj dite, nga shumë fjalë arabe dhe farse, perse, u përhap me shpejtësi në këta popuj ballkanas, ashtu siç përdorehin në gjuhën turke, por duke pësuar ndryshime të dukshme dhe duke humbur përfundimisht karakteristikat a cilësive të arabishtes e të persishtes. Gjuha arabe dhe ajo perse, përdorehin në: besimet fetare, në shkencë dhe në edukimin e popullit, kurse gjuha turke, u përdor në shumë kategori të jetës shoqërore, si në: institucionet e ngritura qeveritare të kësaj perandorie, në shkencë, tregëti, arsim, kulturë, etj.. siç shkrumam në lart. Pra, hemisfera e veprimeve të gjuhës osmano - turke, u përhap dhe përfshiu, si një ortek i fuqishëm, të gjithë jetën shoqërore të asaj perandorie, në popujt e Ballkanit. Kjo që e natyrshme. Donin apo nuk donin popujt e Ballkanit , që të mos ta përdornin gjuhën e pushtuesit, gjuha turke po flitej në popull dhe ballkanasit, detyrimisht, do të flisnin me pushtuesin e egër dhe për myslimanizmin .Të mohosh këtë ndikim do të thotë të mohosh trashëgiminë shqiptare, do të thotë të kultivosh një ideologji ahistorike, gjë që është krejtësisht e gabuar. Islami në Shqipëri, kontaktet e shqiptarëve me botën islame, janë relativisht më të vona se ato të pjesës më të madhe të popujve evropianë. Islamizmi u shfaq për herë të parë i pranishëm në kontinentin e vjetër në fund të mijëvjeçarit të parë (shek. 9-10-të). Me pushtimin otoman nis faza e islamizimit, por me masa shtrënguese përmes zbatimit të sistemit të privilegjuar të taksave dhe tatimeve ndaj muslimanëve, përkundër një sistemi shfazorizues ndaj jomuslimanëve(përrjashtim i atyre që ndërrojnë fenë nga detyrimet ekonomike, nga marrja nizam etj.). Po të vëresh me kujdes e t'i studiosh fjalorët e gjuhës turke, të të gjitha kategorive, syri të sheh, numurin e jashtëzakonshëm të fjalorit arabo - pers apo fars. Këtë gjë e kam vërejtur dhe vëzhguar vetë në Turqi, nga studimi i bërë për përdorimin e fjalëve shqipe, në gjuhën turke. Pra, them me bindje, se fjalori turk, ka në brendësi shumë fjalë nga gjuha arabo - perse dhe shqipe. Edhe i madhi Fan Stilian Noli, e kishte studiuar këtë dëshmi historiko - gjuhësor të turqishtes, kur shkruante se "70% e gjuhës turke, është nga arabishtja, farsa, persishtja. Perandoria e madhe Osmane, nga shekulli 14 - 20, përfshinte a zotëronte tërësinë gjeografike të Ballkanit dhe kështu ajo la një pasuri të madhe në jetën e atyre popujve. Këto trashëgimi historike, fillojnë nga Ura e Monstarit në Bosnje - Hercegovinë, në teqen e Baba Harabatit në Maqedoni, nga Bedesteni në Bullgari dhe deri në "Shtëpitë Osmane", në qytetin e Beratit, në Shqipëri. Në fushën e turkologjisë, janë bërë disa studime, të cilat kanë sjell dhe kanë përcaktuar, ndikimin e turqishtes osmane në gjuhët e Ballkanit. Nga studimi që kam bërë, them se në gjuhën turke ka shumë fjalë të shqipes së lashtë. Kjo tregon se gjuha pellazge ka përfshirë botën. Nuk mundet të themi kurrë se gjuha shqipe ka shumë turqizma, përkundrazi, duhet të shkruajmë se gjuha e lashtë e shqipes, pra, gjuha pellazge, ka hyrë thellë në gjuhën turke. Po, ato janë të gjuhës shqipe. Nga studimi i bërë gabimisht, më parë nga studiues shqiptarë a turkologë, del sikur Fjalori i Shqipes, përmban shumë fjalë të gjuhës turke - osmane. Kjo nuk është e vërtetë. Ato shpjegime gjuhësore, duan me çdo kusht të zhduket gjuha jonë.

Pra, ja, kjo është gjuha jonë e lashtë, që sot Grekët, turqit, sllavët a të tjerë, duan ta asimulojnë për qëllimet e tyre të poshtra. Kjo gjë nuk arrihet se sot ka dokumente. Si rezultat i kësaj "Hyrije të vogël gjuhësore = historike", do të radhisim disa nga më të shumtat fjalë të gjuhës pellazge, që sot ende përdoren në vendet arabe, në Turqi, në gadishullin ilirik, etj. Ato fjalë, po dalin nga errësira në DRITË, nga studimi i etimologëve shqiptarë. Kështu, gjuha jonë po del më në dritë, si Gjuhë Perëndie, siç thoshte dhe bilibili i shqipes, Naim Frashëri. Unë, kam gjetur shumë fjalë të shqipes së lashtë, që janë në fjalorin e madh të turqishtes.

TITULLI I SHKRIMIT: FJALORI I GJUHËS SË LASHTË SHQIPE, NË FONDIN E GJUHËS TURKE

Në gjuhën turke

Aksham
Alamet
Allah
Aman
Emanet
Angarja
Astar
Irgat
Avaz
Avllu
Akhemi
Amxha
Azgën
Bedava
Bahçe
Bajat
Bahshish
Baklava(shkruhet,l.shqiptohet,ll)
Bardak
Bashibozuk
Batakçı (i-turke = ë në shqip)
Bahar
Berber
Bereket
Bez
Bina
Budrum
Bolluk
Boru
Budala (I - shqiptohet ll)
Budalalik (l- shqiptohet ll)
Bilezik
Bucak (C-turke , xh shqipe)
Çakal (shkruhet,l.shqiptohet.ll)
Çay (Çaj,y - j shqipe)
Çapraz
Çürük
Dayak (y-j shqipe)
Dalga (l-ll)
Dalavere
Damga
Tembel
Demet
Divan
Edepsiz
Efendi
Elmas
Frengi
Fukara
Hajdi
Helva
Ambar
Hava
Havadan
Avlli
Ahur (i- turke, ë = shqipe)
Hizmetçi
Ibrik
Inat
Fiçi
Ambar
Avash
Kafez
Kala
Kasap
Kazan
Kismet(i-turke, ë-shqipe)
Katil
Kiyamet(i-turke-ë = shqipe)
Konak
Küfür(ü-turke -y-shqipe) =kyfyr
Lezzet
Mera
Meydan (y-turke -j -shqipe)
Mercan (c-turke- xh -shqipe)
Musluk (l-ll)
Oda
Pancar (c- xh - shqipe)
Pezevenk
Portakal
Kadajif (Kadajef)
Karar
Kelepir
Köfte
Namaz
Raf

Në gjuhën shqipe

Aksham
Alamet
Allah
Aman
Amanet
Angari
Astar
Argat
Avaz
Avlli
Akhemi
Ahx/ë - Xhaxha
Azgan
Badihava
Bahçe
Bajat
Bakshish
Baklava
Bardhak
Bashibozuk
Batakçi
Behar
Berber
Bereket
Beze
Bina
Bodrum
Bollëk
Bori
Budalla
Budallallëk
Byzylyk
Buxhak
Çakall
Çaj
Çapraz
Çyryk
Dajak
Dallga
Dallavere
Damka
Dembel
Demet
Divan
Edepsëz
Efendi
Elmaz
Frengji
Fukara
Hajde
Hallva
Hambar
Hava
Havadan
Avlli
Ahur
Hyzmeqar
Ibrik
Inat
Fuçi
Hambar
Avash
Kafaz
Kala
Kasap
Kazan
Kësmet
Katil
Kiamet
Konak
Qyfyr
Lezet
Mera
Mejdan
Merxhan
Muslluk
Oda
Panxhar
Piziveng
Portokall
Kadaif
Karar
Qelepir
Qofte
Namaz
Raft

Rahat
Sahan
Sakat
Cambaz (c- turke - xh shqipe)
Zincir
Livadi
Dolaşiyor,dollashma
Benim kitap

Rehat
Sahan
Sakat
Xhambaz
Zinxhir
Livadhi
Dal, dola
Libri - im

(përemri pronor "im" i gjuhës shqipe, është pjesë përbërëse e fjalës turke : Ben = im në shqip: Libri im). Kjo tregon se gjuha shqipe e lashtë, gjuha pellazge = pellazgishte, është shpërndarë kudo në botë, se kanë jetuar pellazgët dhe më pas ilirët.

Në këtë rast, folja ndihmëse e gjuhës shqipe "jam ", në turqisht shkruhet: "yim ". (i = në turqisht, shkruhet "ë " në shqip). Kemi të bëjmë me ndryshimin e zanores " a " në shqip e kthyer në "ë" turqisht: a/ë. Jam = Jëm. Kjo do të thotë se fjalët e lashta të gjuhës shqipe, janë pjesë përbërëse të fjalëve apo e fjalorit dhe e fjalive në gjuhën turke, pra, janë vendosur në ndërtimin e tyre në shumicën e rasteve, pra, në FONDIN E FJALORIT TURK.

Edhe në rastin e togfjalëshit të gjuhës turke: "Benim kitap ", që do të thotë: "libri im", fjala "im" është përemri pronor i vetës së parë në numrin njëjës, i gjuhës shqipe. Ky përemër, është pjesë e fjalës "Benim = im, i imi, e imja". Edhe këtu kemi të bëjmë me pronorët e shqipes që janë bërë pjesë e gjuhës turke.

Në këtë drejtim, ka shumë fjalë të gjuhës shqipe, që janë pjesë e fjalëve a ndërtimeve gjuhësore në gjuhën turke. Kjo vërteton se gjuha shqipe e lashtë, është pjesë e fjalorit, e ndërtimeve të fjalëve a të fjalive të gjuhës turke dhe nuk është gjuha turke, pjesë përbërëse tek gjuha shqipe. Pra, gjuha shqipe nuk është e huazuar 93 %, sipas Kolec Topallit e Anila Omarit, nga gjuha turke, greke, sllave, etj..

Etimologët shqiptarë e te huaj kanë folur dhe shkruar, e kritikojnë një veprim të tillë. Ka disa vite që shumë etimologë të shqipes po e shpjegojnë shumë mirë këtë fenomen gjuhësor, duke e hedhur poshtë me argumente shkencore mendimin e gjuhëtareve të cilet kundërshtojne pa fakte origjinën e gjuhës shqipe nga gjuha e lashtë pellazge.

Dokumentet e origjinës së gjuhës së pellazgëve, të shkruara dhe të gjetura në shumë gjurmë arkeologjike, në Shqipëri e nëpër botë, në përdorimin e hartave të lashta, që janë fshëhur nëpër arkivat botërore dhe që tashmë fal studimeve të shumta të etimologëve dhe arkeologëve të gjuhës shqipe dhe të shumë studiuesëve evropianë e botëror, tregon më së mirë se gjuha e lashtë pellazge, ka depërtuar në shumë gjuhë të botës . AJO ËSHTË SOT E NESËR, ÇELËSI I SHPJEGIMIT TË FJALËVE A FJALORIT TË GJUHËS BOTËRORE.

Nga studimi që kam bërë, për 100 fjalët e gjetura në fjalorin e madh me titull : "OSMANLICA = TÜRKÇE SÖZLÜK (Fjalori i gjuhës osmane = turke) me autor Mustafa Nihat ÖZÖN, botimi i pestë i vitit 1973, me afërsisht 30.000 fjalë arabe dhe persiane dhe më shumë se 10.000 idioma dhe klishë që shpjegohen në këtë fjalor, na del se 100 fjalët që radhita më lart, nuk janë me prejardhje të gjuhës arabepersiane, osmane a turke, por janë FONDI I GJUHËS SË LASHTË SHQIPE. Këto fjalë edhe për shumë e shumë fjalë të tjera që përdoren edhe tani në gjuhën shqipe e në gjuhën turke, herë - herë, janë shpjeguar dhe ende shpjegohen si fjalë të gjuhës turke, kur në të vërtetë ato janë të gjuhës së lashtë pellazge e ilire. I përdora këto shënime historike, për të vërtetuar përdorimin e fjalëve pellazge dhe në ditët e sotme.

Në Turqi, çdo ditë dëgjoj fjalë të gjuhës pellazge. Në Turqi kanë vërshuar populli sirian, avgan, palestinezë e të tjerë të botës arabe. Disa herë, kam biseduar me ata, (se dinë dhe turqisht), për disa fjalë, të cilat janë të gjuhës pellazge. Në datën 22.06.2019, duke bërë shëtitje sportive, në Byjyçkëmxhe, Stamboll, pranë Detit Marnara, dëgjoj tek një vajzë 12-vjeçare të shqiptoj fjalën: "mama". I drejtohem nënës së saj duke i thënë turqisht: "Çfarë kuptimi ka fjala "mama"? Ajo më përgjigjet: - Fjala "mama", do të thotë: "NËNË".

Kur u ktheva nga sporti për në shtëpi, përsëri një grup sirianësh: gra, vajza, djem e burra po shëtsnin në atë mbrëmje të bukur. Një vajzë rreth 18 vjeç, me fytyrë shumë të bardhë, me flokë bionde, i thotë nënës (dhe ajo shumë e bardhë): "Mama". Nëna kthen fytyrën, duke e parë ... Edhe nënës së saj, i them: " Çfarë kuptimi ka fjala "mama"? Ajo, më shpjegon të njëjtën gjë, se kjo fjalë ka kuptimin e nënës. Dhe kështu shpesh dëgjoj fjalë shqipe. Në datën 06 .08.2019, duke shëtitur afër Detit të Marmaras, në Byjyçkëmxhe, në një lokal ishte vendosur një tabelë , ku shkruhet: "LIVADI". Bisedoj me punonjësën Ali Ajdogan: - Çfarë kuptimi ka fjala : "Livadi "? Ai përgjigjet: Do të thotë lulishte e madhe, e gjerë, vend me barëra të ndryshme për bagëtinë, kullotë.

Kjo fjalë, i thashë, është e gjuhës shqipe. Ia sqarova mirë kuptimin dhe ai e pranoi shumë mirë. Ai ishte nga fshati i Rizes. Kështu, gjuha pellazge, ende jeton në këta popuj, por ata nuk e dinë origjinën e fjalëve. E dinë se janë fjalë të gjuhës turke, apo siriane , etj. Kjo është gjuha shqipe, ku gjuhëtarët shqiptarë, duhet të bëjnë studime të thella dhe t'i tregojnë botës lashtësinë e gjuhës shqipe = pellazge.

Poesia ❄ Poezi ❄ Poesia ❄ Poezi

SONO NATO IN COLLINA*Di Pierfranco Bruni*

Sono nato in collina
guardando il mare.
Alle onde devo il vento
che mi ha portato il rumore
del tempo e abito le voci
del passato che mio padre
mi insegnò coltivando
le rose del giardino. Ogni
mattina portava una rosa
e il caffè a mia madre
con il sorriso che so
e la malinconia
che mi ha regalato.
Sono nato in paese
tra la collina e il mare
in lontananza.

KAM LINDUR NË KODËR*Nga Pierfranco Bruni*

Kam lindur në kodër
duke shikuar detin.
Valëve u detyrohem erën
që më solli zhurmën
e kohës dhe banoj me zërat
e së kaluarës që babai im
më mësoi duke kultivuar
trëndafilat e kopshtit. Çdo
mëngjes ai sillte një trëndafil
dhe kafënë nënës sime
me buzëqeshjen që e njoh
dhe melankolinë
që më dhuroi.
Kam lindur në fshat
midis kodrës dhe detit
në largësi.

O BOTË E MISHTË!*Nga Aleksandër Çipa*

Në copëra shikimesh që rrëshqanthe
të hidhen,
apo që hiqen,
me ulje përtokë.
Më mjafton të shoh
shpirtin të ndotur,
dhe zgavra me errësirë,
që bashkëjetojnë në një gropë.
O botë e mishtë,
Një copë!

SHI*Nga Aleksandër Çipa*

Ndjej nën këmbë, tokën njomur,
Syri, nëpër mjegull futur.
Në një pritje gjithë mërzit,
Shuplakohem pa u dukur.

NATE E GJATE DIMRI*Nga Lumturije Fortuzi*

Si shpirtrat që fiken
luhaten dritat në errësirë,
po e zë gjumi qytetin e mirë.

Shpejtë ra sot hija e natës,
Si napë nga qielli i nxire.
Kalërojnë karvan ëndërat,
në mëndjet e fjetura
lulëzojnë buzeqeshjet e mërmërimat,
ca zgjohen të trëmbur
nga tmerret që shohin si në filma.
Të lodhur fluturojnë në përjetësi shpirtra,
te tjjere lindin me qarje e britma.

Një natë e gjatë dimri,
që pjellë një ditë të re për njerëzimin,
Një ditë të bardhë qarje e gëzimi.
Në një cep, i ndrojtur pret agimi
të zbresë me zbardhellimin e dites.

PUTHJA E MUNGUAR*Nga Adelina Pali*

Më bëj të lumtur
me tënden aromë,
Digjmë me flakërimat
e vështrimeve të tua.
Më bëj të humbas
tek ty përgjithmonë,
Flaki tej hidhërimet,
asgjë tjetër s'dua!
Lermë të shoh gjoksit
tënd hënën kristal,
Qiellin që ndrit në
shpirtin tënd të shoh,
Të më gulçojë zemra,
të shuaj këtë mall,
Puthja e munga
buzën të më ngrohë!

(TENTATIVË RIME)*Nga Brikena Qama*

një ëndërr më shumë i shtohet natës
e unë e ëndërrt vrapoj pas saj
një puthje e diellit m'i zgjon mëngjeset
dhe diej të vegjël lindin pastaj...

PRIT DHE PAK NËNË*Nga Skender Lazaj*

(Për Nënë kur ishte ende në jetë)

O Nënë, mos i derdh lotët kur unë të kthehem
dhe kokën t'kem mbështetur në prehërin tënd
se kur të bjen mbi buzën time, do dehem
se ata lot, janë ngarkuar me mallë të rëndë!

O Nënë, më këndo ca ninulla si dikur fëmijë
dhe gjumi në t'ëmbilin prehër le t'më kapisë
ditët e mia do të shumëzohen me njëmijë
kur zëri yt, nëpër natë t'më nanurisë...

O Nënë, më rrëfe ca përralla si njëher e një kohe
kur në prehërin tënd, unë o Nëna ime të vijë
të gjitha ç'më tregove, si në shirit filmi i shohë
mes tyre ty Nënë të gjejë, dhe kthehem fëmijë!

O Nënë, prit dhe pak kthimin tim, ja erdha
e di që jam vonuar dhe s'kam shpjegime
por oqeani shpirtit sa s'më derdhet nga ena
prej mallit për Ty Nënë, O mbretëresha ime!

HO CHIESTO*Di Valbona Jakova*

Ho chiesto: buio, sei il mio amore?
Ma il buio mi ha deriso.
Ho chiesto alla luna: sei tu amore?
Un tiepido sorriso è caduto giù.
Ho detto a un sasso, sei bello,
ma il torrente l'ha fatto sparire.
Ho chiesto alla mia terra: amami!
Ma la terra mi ha cacciata via.
Ho detto al ghiaccio: che meraviglia!
Una statua senza cuore mi rese il suo gelo.
Ho detto al sole: sono una viandante,
il sole mi ha scaldato di tanti raggi d'amore.
Ho chiesto alla more: dove sei?
Mi ha aperto un cuore pieno di dolori.

PREHËRI I NËNËS*Nga Ana Bisholla*

Sikur Zoti mos kish bërë ëndërrat,
Nuk di ku vallë do të shikoja?
Lodhjen po vrisja në prehrin tënd,
Dhe nga gëzimi fluturoja.

Nëse gëzimi nuk ka peshë,
Peshën e ndjeva kur u zgjova,
Prehrin e nënës se kisha më,
Me fatin u zura, turfullova.

Të zgjaste ëndërra edhe pak,
Ja, sa të pinim dhe kafënë,
Dhe unë do ikja pa merak,
Dhe ti do hapje penxherenë ...

NË KËTË JETË*Nga Theodhori Proko*

Në këtë jetë i desha njerëzit
Gjithkujt i fala zemrën time
Dhe në asnjë rast si shpërblim
Nuk kërkova falënderime.

Kam qeshur me gaz të shpirtit
Kur kullonin lumturi
Dhe kam qarë me lot të hidhur
Kur trishtim kishin në sy.

Për gjithçka dhashë e gjithçka fala
Asnjëherë s'ndjeva pendim
Kush s'më deshi sa e desha
Është punë e tij, jo faji im!

RRËZIM*Nga Fatbardha Xhani Myslymaj*

Rrëzuar unë
Mbi dashurinë tënde
me dhëmbje...
Rrëzuar ti
Mbi dashurinë time
me dhimbje...
Në këtë
Botë rrëmujë... 1
Dy akuj
Të kthyer
në ujë...

SONTE*Nga Xhevahir Spahiu*

Jetoj brenda syve të tu,
në sytë e mi ti ke shtëpinë.
S'jemi vetvete,
secili është tjetri.
Vera ime ka dy skaje:
njëri në pranverë, tjetri në vjeshtën tënde.
Ti hyn në të djeshmen time,
humb rrugën si ai që ka humbur kujtesën.
Unë hyj në të ardhmen tënde,
humb rrugën si ai që në pyll
s'ka kaluar asnjëherë.
Sa do të doje të kishe në duar
të djeshmen time!
Sa do të doja të kisha në duar
të ardhmen tënde!
Kë të pyes? Cilin yll? Cilën kohë?
Për të djeshmen time ti mund
të pyesësh një lumë,
do lisa, një dem,
edhe varrin e nënës.
Krejt e kotë.
T'i lëmë pyetjet.
Pyetjet le të marrin një sy gjumë.
Sonte jemi vetëm e sotme.

VJESHTË...*Nga Anla Toto*

Natyrë e gjallë më merr, më mbështjell
me zëra, ngjyra e fëshfërima gëthesh.
I hyj në shpirt, nëpër trup e më thellë
të vesh gjithë ngjyrat e kësaj jete...

E më kthehen brengat në zogj që ikin,
nëpër shtegëtime që ndjellin liritë.
Me dritën e zotit më mbushin shpirtin,
në atë ngjyrë të artë, ngjyrë të florinjte...

FAT-THANAT E FATIT TIM*Nga Armenida Qosja*

Emrin tënd thërrasin gjetet,
Një zëri, gjer në frymën e fundit,
"Rri e qetë" m'i thonë zemrës
Fat-thanat e mia të moçme...

Urtohet pritja, psherëtimat shuan,
Butë dhe ëmbël, si të ishin fëmijë,
Dritën u vesh sërisht me gaz syve,
Shijen e puthjeve, buzëve...

Nga çerdhja e tij ngrihet një zog,
Krahët tret përtej reve, drejt teje,
Ty të të rrëfejë tërë çfarë thanë,
Fat-thanat e mia të moçme...

POEZI*Nga Mirela Leka Xhava*

"Ti trokite në portën time të shpirtit
nuk di adresën si e gjete,
nuk di nga erdhe, as se si,
por mbaj mend që flisja me ty si me veten
e brishta, e denja mikja ime poezi.

Qaq shumë vite shkuan me ty dhe pa ty
pa ditur arsyet ndaheshim e vije prapë
por di që kur thërrisja fort brenda në shpirt
ti për çudi atëherë më gjendeshe pranë.

Ti trokite dhe hyre në portën time të shpirtit
pjesëtare e jetës dhe ëndrës sime,
Poezi.«

SHUPLAKË E ATDHEUT*Nga Murat Isaku*

Ora ka rënë dhe vazhdë bie n'frymën tonë,
veshtë të mirremi me sy,
veshtë të mirremi me fjalë,
se një mot kur gjaku ngjizet me tharm -
një ditë vonë,
në fyt vetja do t'na ngecë si një fije halë.

Çdo çast me t'zeztë n'greminë
po biem këmbë dorë
të djegur nga fati - e yllin ballit vrarë...
Pa dëshmi na shpallën fajtorë,
na shpallën fajtorë,
kur n'kripë e helm buzët u çanë -
mbetëm një shtarë.

Po, ku, Zotynë, e nisëm si e sosëm,
thueje or lok,
dhëmbët na u krimbën në shpifje,
çalojmë në çdo rresht...
Sikur mbetëm pas bishti në këtë veran apo t'rok
dhe vdesim nga krahët si një zog në vresht.

Ora ka rënë e bie - tjerët e thonë më lehtë,
vëllezër të ngrohemi në një zjarr shpirti fton
s'kemi ku t'marrim hua tjetër truall, tjetër jetë.
Atdheu po e ngre shuplakën në faqen tonë!

Beato Papàs Josif Papamihali (1912 – 1948)

Di Sergio Conti – Grottaferrata

Beato Papàs Josif Papamihali (1912 – 1948), sacerdote albanese di rito bizantino, martire della Chiesa greco-cattolica albanese. Fu arrestato, condannato ai lavori forzati e barbaramente ucciso per la fede cristiana durante la dittatura comunista in Albania. Si formò presso la comunità monastica italo-albanese dell'Abbazia di Santa Maria di Grottaferrata, Roma.

In Albania, sotto il regime comunista negli anni 1944-1991, sono stati uccisi molti religiosi cattolici, sacerdoti, suore e religiose missionarie. Le accuse con le quali venivano arrestati, torturati e a volte sottoposti a processi dall'esito già scritto erano principalmente due: quella di essere spie della Santa Sede. La difficile situazione dei cattolici albanesi ebbe fine quando, il 4 novembre 1990, la celebrazione di una Messa al cimitero cattolico di Scutari segnò la ripresa della pubblica professione di fede. Da allora, la memoria di quanti avevano dato la vita per la fede si è intensificata e ha portato alla richiesta d'introdurre la causa di beatificazione per alcuni di essi.

Quindi il 10 novembre 2002, nella cattedrale di Scutari, alla presenza del cardinal Crescenzo Sepe, Prefetto della Congregazione per l'Evangelizzazione dei popoli, è stata introdotta la fase diocesana del processo per accertare l'effettivo martirio di 38 candidati, capeggiati da Vincenzo Prennushi (al secolo Kolë), religioso dei Frati Minori e arcivescovo di Durazzo. La lista comprende due vescovi, 21 sacerdoti diocesani, 7 sacerdoti francescani, 3 gesuiti (due sacerdoti e un fratello coadiutore), un seminarista e quattro laici. Contemporaneamente, sono cominciate le cause per la beatificazione del francescano padre Luigi Paliq, morto nel 1913, e del sacerdote diocesano don Gjon Gazulli, ucciso nel 1927; le loro sono state considerate "cause storiche". Le tre inchieste sono state concluse l'8 dicembre 2010, sempre nella cattedrale di Scutari, alla presenza del cardinale Claudio Hummes, Prefetto Emerito della Congregazione per il Clero, e convalidate con decreto del 9 marzo 2012.

Papa Francesco si è così espresso il 21 settembre 2014, nel corso del suo viaggio apostolico in Albania, precisamente durante la celebrazione dei Vespri nella cattedrale di Scutari: «In questi due mesi, mi sono preparato per questa visita, leggendo la storia della persecuzione in Albania. E per me è stata una sorpresa: io non sapevo che il vostro popolo avesse sofferto tanto! Poi, oggi, nella strada dall'aeroporto fino alla piazza, tutte queste fotografie dei martiri: si vede che questo popolo ancora ha memoria dei suoi martiri, di quelli che hanno sofferto tanto! Un popolo di martiri...». Non molto tempo dopo, ossia nel mese di luglio 2015, sono stati presentati alla Congregazione vaticane delle Cause dei Santi i due volumi della "positio super martyrio" di monsignor Prennushi e dei suoi 38 compagni. Il 17 novembre dello stesso anno i consultori teologi si sono pronunciati favorevolmente circa l'effettiva morte in odio alla fede dei potenziali martiri. Il 26 aprile 2016, ricevendo in udienza il cardinal Angelo Amato, prefetto della Congregazione delle Cause dei Santi, papa Francesco ha autorizzato la promulgazione del decreto che ufficializzava il loro martirio. La loro beatificazione è stata fissata al 5 novembre 2016, sulla piazza della cattedrale di Santo Stefano a Scutari; a presiederla, in qualità di delegato del Santo Padre, il cardinal Amato.

Si riporta nell'elenco che segue, ordinato in base alle date di morte dei singoli Beati, tutti i martiri Albanesi che hanno perso la vita per difendere la fede cristiana:

- **Lazër Shantoja**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 5 marzo 1945 a Tirana;
- **Ndre Zadeja**, sacerdote dell'Arcidio-



cesi di Scutari-Pult † 25 marzo 1945 a Scutari;

- **Giovanni Fausti**, sacerdote gesuita;
- **Giovanni (Kolë) Shllaku**, sacerdote francescano;
- **Daniel Dajani**, sacerdote gesuita;
- **Qerim Sadiku**, laico dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult;
- **Mark Çuni**, seminarista dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult;
- **Gjelosh Lulashi**, laico dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 4 marzo 1946 a Scutari;
- **Alfons Tracki**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 18 luglio 1946 a Scutari;
- **Fran Mirakaj**, laico coniugato dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † settembre 1946 a Tirana;
- **Josef Marxen**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Tirana-Durazzo † 16 novembre 1946 a Tirana;
- **Bernardino (Zef) Palaj**, sacerdote francescano † 2 dicembre 1946 a Scutari;
- **Luigj Prendushi**, sacerdote della Diocesi di Sapë † 24 gennaio 1947 a Shelqet, Scutari;
- **Dedë Maçaj**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 28 marzo 1947 a Përmet;
- **Mark Gjani**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 1947 a Shën Pal, Mirditë;
- **Serafino (Gjon) Koda**, sacerdote francescano † 11 maggio 1947 a Lezhë;
- **Gjon Pantalia**, fratello gesuita † 31 ottobre 1947 a Scutari;
- **Anton Zogaj**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Tirana-Durazzo † 9 marzo 1948 a Durazzo;
- **Fran Gjini**, vescovo e abate nullius di Sant'Alessandro a Orosh (attualmente in Diocesi di Rrëshen)
- **Mattia (Pal) Prennushi**, sacerdote francescano;
- **Cipriano (Dedë) Nika**, sacerdote francescano † 11 marzo 1948 a Scutari;
- **Dedë Plani**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 30 aprile 1948 a Scutari;
- **Ejëll Deda**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 12 maggio 1948 a Scutari;
- **Anton Muzaj**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † primavera 1948 a Scutari;
- **Pjetër Çuni**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 31 luglio 1948 (data probabile) a Koplik, Scutari;

Josif Papamihali, sacerdote dell'Amministrazione apostolica dell'Albania del Sud

(Rito greco-cattolico albanese) † 26 ottobre 1948 a Maliq, Coriza;

- **Aleksander Sir-dani**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 26 dicembre 1948 a Koplik, Scutari;

- **Vincenzo (Kolë) Prennushi**, sacerdote francescano, arcivescovo di Duraz † 20 marzo 1949 a Durazzo;

- **Jak Bushati**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 4 aprile 1949 a Lezhë;

- **Gaspere (Mikel) Suma**, sacerdote francescano † 16 aprile 1950 a Scutari;

- **Maria Tuci**, giovane laica, aspirante delle Suore Stimmatin † 24 ottobre 1950 a Scutari;

- **Jul Bonati**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Tirana-Durazzo † 5 novembre 1951 a Scutari;

- **Carlo (Ndue) Serreqi**, sacerdote francescano † 4 aprile 1954 a Burrel, Scutari;

- **Ndoc Suma**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 22 aprile 1958 a Scutari;

- **Dedë Malaj**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 12 maggio 1959 a Scutari;

- **Marin Shkurti**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † aprile 1969 a Scutari;

- **Shtjefën Kurti**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Tirana-Durazzo † 20 ottobre 1971 a Fushe, Krujë;

- **Mikel Beltoja**, sacerdote dell'Arcidiocesi di Scutari-Pult † 10 febbraio 1974 a Scutari.

In particolare si ricorda il Beato **Josif Papamihali**, nacque a Elbasan, nella parte centrale dell'Albania, il 23 settembre 1912. Sebbene di famiglia ortodossa, nell'infanzia si avvicinò alla Chiesa cattolica, ma non voleva rinnegare le proprie origini. Grazie all'archimandrita Pietro Scarpelli, missionario dell'Eparchia di Lungro, ottenne la possibilità di trasferirsi in Italia per ricevere la formazione sacerdotale nel rito greco-cattolico: studiò quindi all'abbazia di Grottaferrata e al Pontificio Collegio Sant'Atanasio di Roma, dove frequentò i corsi filosofici e teologici. Celebrò la prima Messa, o meglio, per la prima volta la Divina Liturgia il 1 dicembre 1935, nella chiesa romana di Sant'Atanasio. L'anno dopo rientrò a Elbasan, diventando parroco della chiesa di San Pietro e ristabilendo, di fatto, il rito greco-cattolico in Albania. "Papàs Sift", come lo soprannominarono i suoi parrocchiani, rimase nella loro memoria per la sua capacità di condurli a Dio e, allo stesso tempo, di risolvere i loro problemi. Aver ospitato nel seminario Benedetto XV nell'Abbazia di Grottaferrata il Beato albanese è stato un privilegio. In questo contesto non può che essere ricordato il volume scritto da Padre Nilo Borgia sui Monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria dei secoli XVI-XVIII Edizioni I:E:O: 1935-1943.

Nel 1945, come molti altri sacerdoti, venne arrestato dalla polizia di regime e condannato a dieci anni di lavori forzati nella palude di Maliq, situata nella regione di Coriza e infestata da animali.

Una religiosa che riuscì a entrare in contatto con lui riferì che i suoi abiti erano impregnati dell'odore del sangue e dei suoi bisogni, dato che non poteva espellerli se non nelle gavette. Nonostante quelle condizioni miserande, i suoi compagni di detenzione hanno testimoniato che era coraggioso e che

non perse la fede. Il 26 ottobre 1948, mentre lavorava nella palude, cadde schiacciato dal peso che gli era stato ordinato di trasportare. I suoi compagni accorsero per sollevarlo, ma le guardie carcerarie glielo impedirono e diedero un'altra consegna: dovevano seppellirlo lì dove si trovava, vivo. Dopo quattro anni, anche suo fratello Kostaq venne ucciso, a Tirana, solo per il suo legame di sangue con lui.

Per anni l'Annuario Pontificio ha continuato a registrare il rito greco-cattolico albanese tra quelli in uso nella Chiesa cattolica, sebbene non ci fossero quasi più fedeli né sacerdoti a praticarlo. Con il crollo del regime, però, anche questa forma rituale è tornata a vivere. È stato compreso nell'elenco dei 38 martiri albanesi capeggiati da monsignor Vinçenc Prennushi, papàs Josif Papamihali è stato beatificato a Scutari il 5 novembre 2016.

Non si può concludere un argomento come questo senza parlare Fu in quella di lavori di liturgia, innografia, storia, melurgia bizantina, che trovano spazio i primi scritti di interesse storico-religioso albanese esistenti nelle biblioteche del Monastero di Grottaferrata. In Particolare ricordiamo di P. Melezio La Piana, Il catechismo albanese di Luca Matranga, P. Sofronio Gassisi, La missione dei monaci basiliani in Albania. Relazioni e lettere. Contributo alla storia di rito greco in Italia La diocesi greco-albanese di Calabria di Nilo Borgia, La questione religiosa in Albania. Seminario greco-albanese nella Badia di Grottaferrata... P. Bartolomeo Di Salvo, La tradizione musicale bizantina delle colonie italo-albanesi di Sicilia e quella dei codici antichi, P. Teodoro Minisci, I Monaci basiliani in Sicilia e in Albania, I rapporti degli Albanesi di Calabria con i Monaci basiliani, P. Marco Petta, Appunti di bibliografia albanese. Non a scopo scientifico, ma di utilità pratica P. Lorenzo Tardo pubblicava il libretto Tufë uratash, composto da preghiere e canti sacri e dai primi elementi del catechismo, il tutto in lingua albanese.

Il nome di P. Lorenzo Tardo ci porta a considerare un altro aspetto dell'attività culturale albanese nel monastero di Grottaferrata, quella cioè della musica. La presenza dei monaci italo-albanesi nella Badia produsse, tra l'altro, anche l'inserimento nelle funzioni sacre dei loro canti liturgici tradizionali. L'uso di questi ne provocò lo studio. E le conclusioni sono esposte dal P. Lorenzo Tardo nel volume L'antica Melurgia Bizantina nell'interpretazione della Scuola Monastica di Grottaferrata, Grottaferrata 1938, dedicato ai canti liturgici delle colonie greco-albanesi di Sicilia, preziosi per lo studio della ricostruzione dell'antica melurgia bizantina. L'opera rimane dopo 70 anni l'unico manuale sulla musica bizantina in lingua italiana. (prof. Sandra Mortani) Prima di P. Tardo, un altro monaco, P. Gregorio Stassi, aveva diligentemente e pazientemente trascritto dalla viva voce dei papàs, specialmente dell'arciprete Alessi di Palazzo Adriano e del parroco Figlia di Palermo, quasi tutti i canti tradizionali di Sicilia.

Manoscritto tanto più prezioso, in quanto alcune di quelle melodie non sono più cantate dalle giovani generazioni. Infine dobbiamo segnalare in campo musicale gli studi di P. Bartolomeo Di Salvo, il quale ha esteso le sue indagini alle comunità greco-albanesi di Calabria, registrandone le melodie e purtroppo mai pubblicate.

Si è voluto ripristinare nella Badia la piena osservanza del rito bizantino-greco, obiettivo pienamente raggiunto grazie anche alla presenza nella Badia di monaci provenienti da famiglie delle comunità italo-albanesi.

Il rito, la liturgia e la storia delle Chiese Orientali furono il campo preferito da questi monaci, che insegnarono al Beato **Josif Papamihali** che la Divina Provvidenza ha collocato al posto giusto, per il bene della Badia Greca di Grottaferrata, della Chiesa e della Cultura bizantina. Sicuramente un Beato caro a tutti i cultori della tradizione bizantina e della Chiesa Cattolica.

Përurimi i shtatores së Skënderbeut

Nga Shqipe Bytyqi – Zvicra

Hora e Arbëreshëve -Piana degli Albanesi me 30 gusht festoi 536 përvjetorin e themelimit të saj dhe me rastin e kësaj feste të madhe u përurua shtatorja e kryetrimt te Arbërisë, Gjergj Kastriotit. Shtatorja e Gjergj Kastriotit -Skenderbeut, iu dhurua arbëreshëve nga shqiptaret e diasporës, me idenë dhe organizimin e Shoqatës Hora e Skënderbeut nga Zvicra, si mirënjohje për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit arbëror për më shumë se pesë shekuj. Prezenca e shumë shoqatave të ardhura enkas për këtë ngjarje kulturore, përs-hfaqti respektin dhe dashurinë e pafund për vëll-ezërit e gjakut të shprishur.

Qindra aktivistë nga mbarë diaspora shqiptare ne fundshtatorin e këtij viti ia mësyen Siçilisë. Shumë nga ta, nga Zvicra, si: Shkolla e vallëzimit Shota, Shoqata Kulturore Shqiptare “Bashki-mi”, Kori i grave Lyra Zvicër” anëtarë të shoqatës “Trojet” të cilët erdhën me një program të mrekullueshëm dhe nderuan arbëreshët me prezencën dhe artin e tyre. Prezenca e Lulezim Jasharit dhe Shukrije Ramadanit si perfaqësues të dy heronjëve kombëtar Adem Jashari dhe Agim Ramadanit i dha sens atdhetarie këtij event!



Kishte ardhur edhe Besnik Desku nga MPJD, politologu Bardhyl Mahmuti, kryetar i Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, Musa Jupolli, kryetar i LKSHM pastaj prof Hazir Mehmeti, Dr Ruki Kondaj, Dr. Faik Elezi, Dr. Ornella Radovicka, Dr. Durrsim Ramadani, aktivisti Agush Buja, ndërmarrësja Teuta Kerhani-Rifati, Balaj Flora qe solli kostumet kombëtare dhe veshi të rinjët dhe të rejtat shqiptare, si dhe shumë e shumë aktivist te tjerë. Jo, vetem nikoqiri, kryetari i bashkisë Hora e Arbëreshëve z. Rosario Petta, por e tërë hora priti musafirët e shumtë me ngrohtësi vllazërore. Ishin dy ditë të rralla festive, permbushur me mall, krenari, kthim tek rrënjët dhe përfaqime vllazërore.

E nderuar që në emër të Shoqatës Hora e Skenderbeut të lexoja një poezi autoriale, dedikuar kryetrimt tone, Skenderbeut! Gazetari dhe miku i madhë i arbëreshëve Rexhep Rifati, ai cili me angazhimin e tij i priu përfaqimit të arbëreshëve dhe trungut shqiptar, pas festimit të ditëlindjes së zonjës tij Hamides, ju drejtua të pranishmëve me fjalët “ejani dhe festoni ditëlindjet te vllëzërit arbëreshë” gjersa Skenderbeu nga dora e mjeshtrit Gëzim Muriqi qëndronë aty në shesh krenar dhe madhështor.

Mësimet e dashurisë

(Përsiatje për librin e Don Lush Gjergjit, “Porositë e Shën Nënë Terezës për ne”, Drita 2024)

Nga Ndue UKAJ

Shen Nënë Tereza është shkollë madhështore e dashurisë, pa një të dytë përreth, prandaj, një libër i ri për të, është një shteg, që të ecim udhëve të reja e një dritare e re që të shohim pamje të reja; të mësojmë nga ky art i të jetuarit dhe nga kjo shkollë e provuar dashurisë njerëzore. Don Lush Gjergji, si studiues i palodhur kulturor e shpirtëror, tash e sa kohë, punon pareshtur që të çelë shtigje të reja drejt njohjes së Shen Nënë Terezës, të hapë dritare të reja, që të soditet bukuria e jetës, përmes zemrës së Nënë Terezës. Si biografi më i shquar dhe studiues i rëndësishëm, me mbi 20 vepra të dedikuara jetës dhe veprës të Shen Nënë Terezës, vepra të përkthyer në 15 mbi gjuhë të huaja, Don Lush Gjergji shpalos përmasën e dashurisë së pakufishme të Gonxhes sonë dhe na thërret, të mbjellim kopshin tonë, me dashuri, ngaqë, si thotë Shen Nënë Tereza e na kujton autori i librit, “dashuria është mjekim për çdo sëmundje.”

Libri i porsa botuar, “Porositë e Shën Nënë Terezës për ne”, me shënimin domethënës, “Në nderim të 45-vjetorit të dhënies së Çmimit Nobel për Paqe, Oslo, 10 dhjetor 1979”, vjen përpara lexuesit si njëllaj lajmëtar i kujdesshëm dhe e ndihmon lexuesin që të hyjë në botën e madhe të shenjtëreshës shqiptare, duke shpalosur aspekte të rëndësishme të jetës së Shën Nënë Terezës: botën shpirtërore, dashurinë për njeriun e Jezusin, aftësitë e saj për të zhvilluar dialog, lidhjen me kombin shqiptar, dëshmi që paraqiten në faqet e para, përmes testamentit që Nënë Tereza dha në Oslo, përpara botës, kur pohoi se ishte shqiptare, duke paralajmëruar kështu një përlindje të madhe kombëtare. Dhe 45-vjet më pas, ky libër, përveç se aktualizon personalitetin shumë-dimensional të Shen Nënë Terezës, vjen mes nesh si një mësim i mirë kundër harresës.

Duke u nisur nga fakti empirik se mësimi më i mirë është mësimi nga njerëzit e mirë, libri i Don Lushit paraqet përpara lexuesit një njeri të mirë, me vepra e mësim praktikë të mira, ku shtjellohen e përditësohen vlerat sublime: dashuria e cila rrezaton si shtylla kryesore e veprimtarisë së Shen Nënë Terezës. Libri na tregon se “mëkati më i madh është mungesa e dashurisë” dhe duke na treguar këtë të vërtetë, na grish që të hyjmë në udhën e bukur të mësimëve të Shen Nënë Terezës, të hyjmë në kopshin e saj të magjishëm e të ushqehemi me vlera jetëdhënëse.

Don Lushi përmes këtij libri të bukur, me fotografi të bukura, e ri sjell portretin e shenjtore, vazhës që doli nga gjiri ynë e nga tokat tona, dhe në kohë trazimesh të mëdha globale, u nis në dherat e Indisë, e vazhdoi pelegrine nëpër botë, për t’u kthyer në vendin e saj, si nënë frymëzuese. Dhe Don Lushi duke qenë bashkudhëtar i saj e njohësi më i përthelluar, porositi e Shen Nënë Terezës, si mësimë dobiprurëse, i sjell mes nesh, që të galdojmë për bukuritë e jetës, sepse, thotë Shen Nënë Tereza:

“Gëzimi është një nevojë, një dhuatë e madhe për të tjerët edhe për ne, është flaka e dashurisë.”

Pra, Gonxhja, ajo vajza e re, që e donte poezinë e këngën, e këputur nga kopshti me lule i tokave të hershme dardane, që herët mbillet si lule diku në një vend të largët të botës, në një mjedis ku varfëria e mjerimi kishin vizatuar fytyrën më të shëmtuar, dhe nga ajo lule e vockël, u bë një kopsht madhështor, që sot



lulëzon anë e kënd botës. Gonxhja, vajzë e re, që herët, braktisi huret e vajzërisë, i dha një lamtumirë të pikëlluar nënës Drane e familjes dhe përmes dallgëve të forta të jetës, në shekullin e egërsisë, u kthye në nënë për gjithë njerëzimin; nënë për të gjitha kombet, gjuhët, fetë e shtresat sociale. Ajo duke vepruar e duke e parë në secilën qenie njerëzore të mirën, i la botës testamentin madhështor të humanizmit; e mësoi njeriun që ta dojë jetën, ashtu siç është, plotësisht, pa pretendime, siç bëri ajo përditë, me njerëz të uritur, të braktisur, të lënë pasdore, dhe me ta, krijoi simfoninë e shpresës, një himn të dashurisë e të solidaritetit njerëzor.

Libri i Don Lushit është një aktualizim domethënës në rrethanat tona, sepse, siç thotë autori, jeta e saj “është një porosi në vazhdimësi për mbarë botën, sidomos për ne shqiptarët”, që të mësojmë se dashuria është mjekimi i çdo sëmundje dhe falja vlerë e epërme njerëzore, sidomos në një kohë, kur duket sikur sillemi të trullësuar përballë botës e vetvetes, në një kohë kur e kemi humbë aftësinë që të bisedojmë me botën e me njeri-tjetrin. Në këtë aspekt, libri e thërret lexuesin shqiptar, të mendojë udhën e gjatë që bëri kombi ynë, për të fituar lirinë, për çka, Nënë

Tereza është shumë meritore, dëshmi kjo e pohuar nga udhëheqës botërorë. Shen Nënë Tereza është e përbotshme, por neve si pakkujt na takon të bëhemi nxënës të kësaj shkolle, të mësojmë nga ajo e të marrim energji për të mirën tonë e të njerëzimit, e në ç’drejtëm, ky libër ndihmon shumë.

Porositë e Shen Nënë Terezës, këshillat e thjeshta prej Nënë, janë vlera ushqyese për zemrën e mendjen njeriut, çdo herë e në çdo kohë, sepse burojnë nga një zemër e madhe e me përvoja të forta, nga një zemër që pati vend për të gjitha dhimbjet dhe gëzimet e botës. Ja një nga to: “Mos më thuaj se në botë ka luftë. Mos më thuaj se njerëzit veniten nga uria. Mos më thuaj se njerëzit vriten nga urrejtja. Mos më thuaj se njerëzit gërgasin dhe përdjekin njeri-tjetrin, por vetëm më thuaj: Ç’bën ti?”

Shen Nënë Tereza, nuk vulviti flamuj ideologjikë, partiakë, shtetërorë, ajo jetoi e punoi nën flamurin e dashurisë njerëzore, atë flamur ia dhuroi botës, duke e bërë fuqinë e tij të rrezatojë kudo e kurdo, edhe nën rrebeshin e armëve, aty ku dora fuqisë së shkencës, e parasë dhe e politikës, nuk mund të depërtonte. Don Lush Gjergji këtë flamur e ka sjellë mes nesh dhe na pyet: ç’bën ti me të? Dhe sot, në një ditë si kjo, tek kujtojmë lindjen e shenjtëreshës sonë dhe përurojmë librin e Don Lushit, si shkrimtar, më takon të them pak fjalë për profilin krijues të Shen Nënë Terezës, sepse, ajo kishte një shpirt të madh krijues e artistik. Ajo ishte poete me mendim të thella, një krijuese, në kuptimin më të lartë të fjalës, që kënaqej me fuqinë e artit e të poezisë dhe botës i la vargje magjepse e një filozofi mahnitëse. Poezitë e saj janë si ilaç për t’i kuruar vuajtjet njerëzore, për t’i bërë ato më të përballueshme, për të mësuar nga jeta dhe njëkohësisht për t’iu gëzuar çdo momenti. Në këtë aspekt, siç thotë Papa Gjon Pali II, te “Letra dërguar artistëve”: “Nënë Tereza, na shfaqet edhe “një rojtare e së bukurës në botë.”

Po ashtu, lë të kujtojmë se Shen Nënë Tereza, fal veprimtarisë së Don Lush Gjergjit është bërë pjesë e edukimit të një breznie të tërë, që në vitet nëntëdhjetë, kohë kjo e thyerjeve të mëdha dhe e transformimeve shpirtërore e politike. Asokohe, për ne që jetonim në Kosovë, filloi një kalvar i vërtetë i vuajtjeve, dhe ne, si nga një e çarë qiellore, shihnim një dritëz shprese, të një forcë të epërme, që na injektonte me besim. Ishte Shen Nënë Tereza ajo që u shfaq mes nesh, me mësimet e buta e shpresëdhënëse, të Nënë, dhe si thoshte presidenti ynë i papërsëritshëm, Ibrahim Rugova, ajo u bë “Engjëlli ruajtës për Kosovën dhe për popullin shqiptar.”

Libri i Don Lushit na ndihmon të ofrohemi me nënën tonë të dashurisë, na mundëson të udhëtojmë në jetën e saj, në historinë e familjes së saj, në kontekstin sociale e kulturor shqiptar, na tregon se “buzëqeshja kushton pak, por dhuron shumë” dhe si i tillë meriton të lexohet, për dashurinë që transmeton te lexuesi, për faktet e meditimet domethënëse rreth përmasës shpirtëror të shenjtës sonë, për gjuhën e rrjedhshme e të qartë me të cilën është shkruar, dhe para se gjithash, për dashurinë e pafund me të cilën Don Lush Gjergji i blatohet Shën Nënë Terezës dhe kombit të tij.

(Prishtinë, 26 gusht, 2024, në Akademinë Solemnë për nderimin e ditëlindjes të Shën Nënë Terezës.)

NJË TAKIM I THJESHTË, MBRESA TË PASHLYESHME ME PROFESOR FANE TARIFËN

Nga Piro Millona Minella – Tiranë

Jam lindur në fshatin Hundëkuq afër Labovës së Zhapës. Aty belbëzova fjalët e para, hodha hapat e para, lojrat e para. Fillova të rritesha. Kishte një problem për shkollimin. Duhej të shkoja në Erind atje ishte shkolla. Largësia e konsiderueshme, çdo ditë përshkoja për 4 orë rrugë në ato vende. Ngrihesha në orën 4 të mëngjezit. As këndeza e fshatit nuk kishin kënduar akoma. Natë e frikshme. Rrëmbeja çantën e thjeshtë prej robe, ku vendosja me kujdes librat e mbështjella me aq dashuri. Xhepat e mi të vegjël i mbushja me gurë. Ecja si mund të ecë një fëmijë, me frikë e ankth. Gurët ishin arma ime. Kam ndeshur edhe ujqër në ato vende të egra. Rrugës kaloja edhe dy kisha, për mua ishin shumë të frikshme. Arrija gjithmonë para se të fillonte mësimi. Nxënës tepër i zellshëm. Rrugën e kthimit e bëja pothuajse me vrap. Vitet rridhnin dhe unë kisha marrë shtatin e një djaloshi të ri, plot energji për dije..... Nuk më mungonte vullenti dhe zelli për të mësuar dhe vitet e shkollës të mesme pedagogjike “Pandeli Sotiri” në Gjirokastrë. Ecuria ime nuk njohu notë tjetër veç 5, atëherë ishte sistemi deri në pesë nota. Mbarova me medalje ari. Unë kam kujtime të bukura nga ai qytet kur isha në Shkollën Pedagogjike “Pandeli Sotiri”. Kam mbresa të pashlyera për mësuesit e saj. Po të përmend Tomorr Tushe dhe Myzafer Asllanin. Isha “kanakari” i Profesor Myzaferit. E di që kur mungonte profesori, unë isha “asistenti” i tij, dilja e zhvilloja mësimin.... Ditën e parë të punës do të ishte në fshatin Zhytomtë të Beratit. U trondita, nuk e mendoja kurrë këtë emërim kaq larg familjes në atë moshë akoma të njomë. Nuk shkova, më thirrën në Degën Ushtarake dhe më plotësuan dokumentat për tu përgatitur si oficer. Shefi i Degës Ushtarake i asaj kohe ishte në provimin e maturës në matematikë. Më kishte fiksuar. Kështu një ditë erdha në Tiranë. U paraqita në Akademinë Ushtarake, dorëzova aplikimin, që më kishte dhënë me vete Dega Ushtarake e rrethit dhe mora leje të flija, atë natë tek një kushëri im. Më pritën ngrohtë dhe djali i madh i kushërit, kur mori vesh se diploma ime ishte me të gjitha 5, u çudit dhe mori në telefon sekretaren e Ministrit të Arsimit dhe pasi bosodoi më tha: -Dorëzo Ministrit mbi tavolinë diplomën e shkollës të mesme, e shoqëruar me medaljen e artë, duke i thënë nuk më duhet dëftesa, mbajeni ju, se gjersa nuk më doli e drejta e studimit për shkollë të lartë. Dhe kështu të nesërmen tërë ankth, arrita në Ministrinë e Arsimit gjysëm ore para. Takova sekretaren dhe ajo hyri brenda dhe pas pak doli duke më thënë së; Ministri ju pret! Më dëgjoi më vëmendje. Nuk foli, pastaj mori në telefon Gjirokastrën dhe pasi mbylli telefonin ma shpjegoi “arsyen” e mosdhënjes të së drejtës të studimit. Në seksion të arsimit kishte ardhur një letër nga Kryetari i Këshillit të bashkuar, ku e cilësonte familjen time si “kulak”. Në sytë e mi thirri një nëpunës dhe në prezencën time i tha: -Rregjistroje këtë djalosh të zellshëm



në një nga degët vakante. Nënunësi midis vëndeve vakant përmendi dhe biokimi. Minsitri më pa në sy dhe më pyet: -A të pëlqen biokimia. Unë kërceva përpjetë nga gëzimi rufeshëm u përgjigja me zë të fortë: -Po. Të nesërmen fluturova për në fshat. Sapo mbërrita, ata më panë të habitur: -Pse erdhe a nuk do të vazhdosh për oficer. Këtu bujqësia të pret. Me frymën që më mbahej nga emocionet u tregova tërë historinë e të drejtës së studimit të fituar vetë ballë për ballë me pushtetin. Kështu bëra përgatitjet e nevojshme dhe ditën e rregjistrimit u paraqita në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, përballë Maternitetit. Isha studenti më i ri i asaj godine. Përvesha mëngët dhe gjithë jeta ime studentore ishte “Mësimi” Katër vjetët fluturuan shpejt dhe në përfundim në diplomën time ishin nga 22 nota vetëm një nota 9, të tjerat të gjitha 10. Më dhanë diplomë të kuqe e shkruar me gërma ari. Pas kësaj filloi karriera ime. Emërimi i parë më shokoi. Isha caktuar mësues në Gjadër të rrethit të Lezhës. Ditën e parë të shkollës si mësues u paraqita dhe duhej të jepja mësim muzike. Një hall më vete. Por vullneti ishte i madh dhe dëshira për punë. U bëra mësues i “zëllshëm” për muzikë. Më vonë erdhi emërimi im si mësues në Teknikumin Ekonomiko-Bujqësor në Lezhë për tre vjet dhe dy vjet si N/Drejtor në Manati dhe Zejmen. Puna ime në Lezhë ishte sepse për herë të parë krijova kabinetin e kimisë në Shkollën e Mesme Ekonomike. Pastaj më transferojnë në Tiranë dhe kur prisja të isha mësues për biokimi, më caktojnë të jap Materalizëm Dialektik si Pedagog kryesisht në

Fakultetin e Mjekësisë dhe pastaj për afro 10 vjet në Institutin e Fiskulturës “Vojo Kushi”. Në Tiranë u specializova në Filozofi. Për këtë qëllim dhashë 4 provime pasuniversitare dhe mora master në lëndën e Materializmit Dialektik. Synimi ishte që atë lëndë ta lidhja sa më mirë me fakte e argumente shkencore mbi bazën e njohurive që kisha marrë nga Dega e Biokimisë. Në vitin 1989 mbrojta doktoraturën në Sociologji. U specializova në Sociologji. Për marrjen e një masteri aty dhashë 5 provime pasuniversitare që konvergonin dhe me temen e disertacionit. Si teme disertacioni mu dha : “Sociologjia e kulturës fizike e sporteve”. Për këtë qëllim u përgatit një material dhe u bënë disa botime e referime shkencore. P.sh u bë një studim i integritit të parimit të lidhjes e kushtëzimit reciprok me efektet në organizmin e njeriut sipas abatomo-patologut Strukov. U botuan dy studime për anët e ekologjisë dhe ndikimet e tyre. Bëra disa artikuj tek buletini kultura fizike e sportet. Kështu botova: “Objektivizmi në sport”. “Olimpizmi si ambasador i paqes” dhe “Frustacionet dhe shfaqja e tyre në aktivitetet sportive” dhe artikuj të tjerë. Disertacioni u mbrojt në katedrën e Filozofisë. Pastaj u mbrojt në Këshillin Shkencor të Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike. Në fazën e tretë u mbrojt në komisionin e lartë të atestimit dhe më në fund mu akordua grada shkencore. “Për punë të mirë si mësimdhënës dhe edukative” më dhanë dekoratën “Naim Frashëri”. Erdhën ndryshimet në sistemin politik të vendit dhe në kohën e demokracisë. Në vitet e tranzicionit politik kam dhënë mësim në lëndën e Sociologjisë dhe në Hyrje në logjikë në dy universitete private. Tek Universiteti “Planetar” dhe Universiteti Ndërkombëtar. Tek Universiteti Ndërkombëtar kam dhënë leksione edhe në biokiminë mjekësore në degët e Farmacisë dhe Infermerisë. Më vonë punova për 6 vjet me firmën e karburanteve “IAP” dhe 5 vjet në firmën gjermane “Wurth”. ...Në profesionin si financier. Kam botuar libra në kohë dhe për problematika të ndryshme: Libri i parë : “Mall për vendlindjen”. Përmbledhje me poezi. Libri i dytë: “Mozaik nga lashtësia”. Përmbledh rrjedhat historike të fiseve që kanë banuar në fshatin tim. Është mpleksje proze e poezi, por më shumë mbizotërojnë prozë dhe shoqërohet edhe me figura. Libri i tretë: “Lodroj ndër mbresa”. Është libër që u kushtohet banorëve aktual të fshatit tim. Libri i katërt: “Përjetime shqiptare”. Ky libër i kushtohet dukurive të vendit tim në kohën e tranzicionit. Në të ka analiza komente e informacione mbi disa “çudira” shqiptare. Është më shumë në prozë por përmban edhe disa poezi. Libri i pestë: “Mbipesha e zhgënjimeve”. Trajtohen më shumë objeksione e qëndrime të pseudodemokracisë shqiptare. Është libër i ndërthurur me përjetime të situatave shqiptare. Libri i gjashtë: “Turbulencat në politikën shqiptare”. Ky libër trajton luhatjet dhe variablat subjektivistë të politikës shqiptare. Libri i shtatë: “Midis zigzakeve të historisë”. Është një libër përmbledhës në poezi e prozë dhe rreh probleme kombëtare dhe të situatës në vendin tonë.

FESTË E KRENARI PËR TITULLIN

Nga Petrit Aliaj – Brescia

“Krenaria Shqiptare”, një emër me të cilin kanë pagëzuar shoqatën e tyre themeluesit e saj në komunën Azzano Decimo të provincës Pordenone në Itali. Sigurisht që në nder të të gjithëve është ajo çka duhet mbrojtur me dinjitet dhe në unitet, vlerat tona në një shoqëri të integruar në bashkëjetesw e paqe me vendasit. Afërsisht një vit më parë mw 28 qershor 2023, nisi rrugëtimin e saj organizata vullnetare “Krenaria Shqiptare” e përfaqësuar nga aktivistë e intelektualë të përkushtuar, të cilët punojnë e kontribuojnë si përbashkues të popujve më kryesorë në dy brigjet e Adriatikut për një hapësirë marrëdhëniesh të gjithanëshme në shtratin natyral të qytetërimin evropian, e të barabartë si qytetarë evropianë. Aktivitetet e saj edhe pse për pak kohë, kanë fituar besimin e komunitetit shqiptar në provincë, si edhe të autoriteteve vendore. Pikërisht arritjet dhe rezultatet janë mudi dhe bashkëpunimi i drejtuesve të saj me president z. Ndrim Kërçuku, Florian Fusha, Petrit Mullaj, Elvana Fortuzi, Ervin Kërçuku, Nesret Tartani, Gerta Ramaliu e Ermal Herri, të cilët kanë marrë masat që së shpejti të hapin edhe kursin e gjuhës shqipe për fëmijë.

Në bisedë me zotin Kërçuku më tha se: “ne si staf së bashku me mësuesit,jemi të angazhuar që të kapërcejmë vështirësinë më të madhe me disa prindër që nuk komunikojnë me fëmijët e tyre në gjuhën shqipe për shumë arsye banale dhe hezitojnë ti sjellin ata në kurs”. Për sa



mësipër dhe në tërësi, ky fenomen sa indiferent dhe kozmopolit, qartësisht tregon mungesë kulture e respekti për gjuhën si edhe ndaj atyre që na kanë bërë kokën, duke qenë një rrezik potencial në procesin e kundërt të kujtesws, harresën.

Pastaj indiferenca e moskujdesjes shtetërore për ta shpëtuar gjuhën shqipe nga tatëpjeta me marrëveshje dypalëshe Shqipëri-Itali, që gjuha shqipe të jetë një gjuhë e zgjedhur në ato shkolla ku mësojnë fëmijët me prejardhje shqiptare.

Jo vetëm në këtë festë, por edhe në të tjera festa,vihet re që në valë së bashku me prindërit e tyre kërcejnë edhe fëmijët, aq sa gëzimi dhe entuziasmi që përshkon fytyrat e tyre të ngazëlluara na i shton harenë edhe në të rriturve. Pra një rast, një dukuri bindëse, e

cila na kujton se është forca e nënës është ajo që ndikon në formimin e fëmijëve dhe ku secili prind i larguar nga atdheu do të pendohet një ditë që nuk u ka mësuar fëmijëve gjuhën që ja ka lënë trashëgim nëna e tyre.

Dhe jo për atdhetarizëm, por edhe për kulturë dhe për interesa të komunikimit në përdorimin e saj kur shkojmë me pushime në vendet e origjinës, që fëmijët të mos rrijnë si të habitur përballë kushërijve, të afërmve e moshatarëve të tyre, duke kërkuar nga prindërit që të vihen në rolin e përkthyesit etj.

Festimin e këtij përvjetori e deklaroi të hapur znj. Elvana Fortuzi, duke ja kaluar fjalën e përshëndetjes presidentit të Organizatës Vullnetare z. Ndrim Kërçuku, i cili falenderoi të ftuarit dhe të pranishmit për praninë e tyre në këtë përvjetor premtues, të cilin ai ia dedikoi edhe punës së përbashkët të aktivistëve; Ilir Ibrahim, Ardian Kërçuku, Elton Sefa, Edmont Zylfo, Neda Koni, Gentian Zylfo, Klodian Kërçuku, Gentian Qyrfyçja, Arjan Mullaj, Anila Fortuzi dhe Ervin Ramaliu (këshilltar në komunë).

Me këtë rast edhe unë përshëndeta pjesëmarrësit për vlerësimin e këtij përvjetori me urimet për vazhdimësi në komunitet dhe mbarësi në familjet e tyre, sikurse përgëzova edhe stafin e organizatws vullnetare “Krenaria Shqiptare” për bashkëpunimin dhe aderimin e tyre në Federatën Kombëtare të Shoqatave Shqiptare FNAI

(It.) Hareja festive shoqërohej nga zërat melodiozë të këngëtarëve Eglantina Toska dhe Indrit Kapllani në hapësirën e qendrës së aktiviteteve “Madonna del Bembo”, hapësirë e cila u përshkua nga zinxhiri i valleve tona masive tradicionale, e një miori personash që kërcenin e këndonin me veshjet e simbolet tona kombëtare.

Në festa të tilla me përmasa të mëdha arrita të njihem me mjaft persona ku edhe pata kënaqësinë të takoja motrat Anila dhe Elvana, vajzat e znj. Lumturie Fortuzi (poete e piktore) dhe të z. Zydi Fortuzi, ish përgjegjës i rregjistrimeve muzikore popullore e folklorike në Radio Tirana, i cili me punën e tij pasionate arriti futjen së tyre në fonotekën e saj. Me këtë rast më vjen mirë të evidentoj punën e tij të spikatur e të përshkruar bukur në librin “Gjurmë të Arta”, të cilin zoti Fortuzi ma dërgoi me postë disa ditë më parë. Kushdo që do ta lexoj këtë libër të mbushur me mbresa e kujtime nga festivalet e këngës në Radio 1962-1975 e të shoqëruara me fotografi do të ndjej admirim e respekt për autorët, krijuesit, interpretuesit dhe drejtuesve, të cilët edhe pse të censuruar nga sistemi i asaj kohe nuk u frigan.

Në këtë festë unë shoqërohesha nga dhëndëri im z. Mauro Carota, i cili është pjesëmarrës në disa konferenca e manifestime kulturore të komunitetit shqiptar në Itali dhe njohës i gjuhës shqipe. Faleminderit miq të Organizatës Vullnetare “Krenaria Shqiptare” për ftesën dhe momentet e bukura që kaluam së bashku. Suksese dhe rrugë të mbarë mësimdhënies së gjuhës shqipe.

LILIANA GJIKÀ, HEROINA E BIBLIOTEKËS SË VLORËS

Nga Albert HABAZAJ - Vlore

Drita e ngohtë njerëzore

Jo vetëm në Vlorë, por edhe në Fier, Durrës, Elbasan, patjetër në Tiranë e gjektë, po u përmend emri i Bibliotekës Publike "Shevqet Musaraj" të qytetit të Vlorës, kolegëve dhe miqve të librit, u del para syve portreti me dritë të ngrohtë njerëzore i zonjës fisnike Liliana Gjika. Fuqia e imazhit të saj është mbresëlënëse dhe nuk është thjeshtë rrjedhojë e punës shumë vjeçare si specialiste shembullore dhe drejtuese model në Bibliotekën e qytetit të madh të Shqipërisë Jugperëndimore, sepse bibliotekat shqiptare kanë plot të tillë që e bëjnë punën me përgjegjësi të lartë, humanizëm, përkushtim dhe ndershmëri profesionale. Vetëm falë virtyteve të larta njerëzore që mbart dhe aftësive teorike - praktike në fushën e Bibliotekomonisë, mund të jesh punëtor i mirë i librit (në çdo pozicion të organigramës).

Jetëshkrimi i Lilianës dhe i Bibliotekave të Vlorës

Liliana Lako Gjika ka lindur në Pojan të Fierit më 19 Shtator 1950. Pas mësimeve në shkollën e mesme Pedagogjike, u emërua mësuese në fshatin Cakran. Kreu studimet e larta në Fakultetin Histori - Filologji, dega Gjuhë - Letërsi, 1971-1975, si dhe kursin dyvjeçar të Bibliotekës, 1975-1977. U emërua në Bibliotekën Publike të qytetit të Vlorës, në sektorin e Periodit Shqip dhe të Huaj, ku u mor edhe me studime albanologjike. Në vitet 1990-2000 u emërua drejtore e Bibliotekës Publike "Shevqet Musaraj", Vlorë. Ka shkruar mjaft artikuj publicistikë për rolin e shtypit në jetën njerëzore dhe për autorët të njohur të letërsisë dhe artit. Ka botuar librat: "Pavarësia kombëtare dhe Ismail Qemali në shtypin e viteve 1990-1982 (1983), "Autorë të huaj për Vlorën" (1987), "Biblioteka Publike "Shevqet Musaraj" (2006), "Njeriu me respekt të male" (2016).

Emrin e saj e përmendim me shumë nderim e mirënjohje ish - kolegët mësues dhe ish-nxënësit e saj, jo pak nga të cilët sot janë emra të dëgjuar në fusha të ndryshme të jetës, ekonomisë, arsimit, kulturës dhe politikës shqiptare. Emri i saj është i lidhur ngushtë si pakkush tjetër me institucionin ku ka punuar; ajo me Bibliotekën e qytetit të Vlorës. Dashamirisht, duke marrë shkas nga dy vargje të Majakovskit, po heq një paralele: "Kur themi Liliana Gjika nënkuptojmë Bibliotekën e Vlorës, kur themi Biblioteka e Vlorës, nënkuptojmë Liliana Gjikanë". Në qytetin e Vlorës dhe hapësirat e saj, tradita e bibliotekave është e hershme, pasuria e dokumenteve dhe dorëshkrimeve shfaqet qysh në Mesjetë me Bibliotekën e Manastirit të Klllogrit në Kaninë, dhe Manastirin e Zvernecit. Gjurmët e bibliotekave të Vlorës gjenden qysh në shek. XV-XVI me Bibliotekat Fetare, Bibliotekat e Himarës (shek XVI) etj. Kodikët e Vlorës janë dorëshkrime të rralla, më të vjetrat që janë ruajtur në hapësirën vlonjate, që si shkrime ungujlore dhe biblike në Shqipëri janë pjesë e historisë botërore të shkrimit; pjesë e historisë së zhvillimit progresiv të mendimit dhe të kulturës njerëzore... Historiku i Bibliotekave të Vlorës ka të regjistruar Bibliotekën e Mekatit (1672), ka Bibliotekën e Familjes Vlora, e përmendur qysh në mesin e shek. XVII, ndër më të njohurat dhe në Ballkan, po ashtu ka Bibliotekën e Odës së Tregtisë (krijuar më nëntor 1920), Bibliotekën e intelektualit Lluka Karafili (1912), Bibliotekën e Arsimitarëve (Biblioteka e vogël - 29.09.1936, ndërsa në ndërtesë më vete - më 7 Mars 1939), Bibliotekën Publike "Shevqet Musaraj" Vlorë, Bibliotekën Shkencore "Nermin Vlora Falaschi" (1994), si dhe bibliotekat e fakulteteve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Biblioteka e Vlorës, që më vonë mori emrin Biblioteka Publike "Shevqet Musaraj" Vlorë u themelua më 22 gusht 1946. Me fondin e librave të "Bibliotekës së Arsimitarëve" rreth 5156 libra, si dhe atë të familjes së Egerem bej Vlorës, u krijua ky institucion kulturor, i cili më pas u pasurua edhe me dhurimin e librave dhe revistave nga intelektualët e shquar të qytetit: Ibrahim Shyti, Ali Asllani, Musa Jonuzi, Dr. Ali Mihali, Jani Minga etj. Deri në vitin 1974, biblioteka e kryente verpimtarinë e saj në godinën e Egerem bej Vlorës. Po këtë vit, ajo u vendos në godinën e familjes hebreje Matathia. Në vitin 1993, u vendos në mjediset e Pallatit



Liliana Gjika feks

Të gjitha ato zonja apo zotërinj që punojnë me librin, për mendimin tim, janë më të mirët, më të përkushtuarit, më të ndershmit, që me dashuri profesionale dhe buzëqeshje prilli, bëjnë miq të librit qytetarët e gjithë grupmoshave dhe niveleve të ndryshme arsimore, sepse libri është diell dhe specialistët dhe drejtuesit e bibliotekave i duan rrezet e diellit për qytetarët e tyre. *Lajtmotivi ynë është: Bibliotekat ndërtojnë komunitetin. Komuniteti ushqen familjet. Familjet pasurojnë jetën. Jeta kërkon lirinë. Liria respekton dijen. Dija ushqen të kuptuarit. Të kuptuarit prodhon ide. Idetë mbështesin komunitetet. Komunitetet kanë nevojë për bibliotekat. Bibliotekat ndërtojnë komunitetin.* [ALA =Shoqata Amerikane e Bibliotekave, 1999].

Në bibliotekën e qytetit të Vlorës, për një kohë 35 vjeçare (1974-2009) ka punuar dhe për gati 20 vjet (1991-2009) ka drejtuar me kulturë dhe dashamirësi zonja Liliana Lako Gjika, sa që i dha kësaj Mëmëzonte të rëndë e fisnike rreth 90 vjeçare - Bibliotekës së nderuar të qytetit tonë fytyrën e saj

të Kulturës "Labëria", por me kërkesën e intelektualëve të qytetit, u bë e mundur vendosja në mjediset e godinës së ish- Bankës Agrare, ku gjendet sot. Eh, moj bibliotekë e Vlorës! Ku s'të hodhën e ku s'të degdisën!...Pavarësisht nga kushtet, njerëzit, që i shërbyen e bënë një filigran të artë shkronjor për qytetarët

Biblioteka Publike "Shevqet Musaraj" Vlorë zhvillon një veprimtari të gjerë në shërbimin ndaj lexuesit për dhënie e një informacioni të gjerë kulturor, artistik e shkencor. Drejtimi kryesor i veprimtarisë së saj ka qenë pasurimi i fondeve, përpunimi tekniko-shkencor, diskutimi dhe promovimi i librave të autorëve të letërsisë shqipe e asaj të huaj. Deri në vitin 1995 në fondin e kësaj biblioteke gjendeshin 120.000 ekzemplarë (kopje/ copë). Në vitin e mprapshtë 1997, biblioteka e Vlorës u dëmtua rëndë nga trazirat e atij viti të zi, jo vetëm për Vlorën, por për gjithë Shqipërinë. Me vendosjen e Bibliotekës në mjediset e reja, sipas vendimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, u bë rikonstruksioni i saj me financimin dhe ndihmën e fondacionit Soros. Mjediset e reja të Bibliotekës janë të një standardi bashkëkohor, për të shfrytëzuar të gjitha pasuritë e fondeve që gjenden aty. Brenda kësaj hapësire ndodhet edhe mjedisi për fëmijët, i cili është mjaft i këndshëm për të vetëpunuar në sallën e vetë. Biblioteka i shërben një popullsi mbi 180 mijë banorë. Ajo ka lidhje e bashkëpunim me shkollën, shoqatën, personalitete të shquara, me Universitetin "Ismail Qemali" etj., duke zhvilluar një sërë veprimtarish kulturore e shkencore. Ajo afron shërbime me fonde të hapura në të gjithë sektorët e saj. Kohët e fundit janë bërë përpjekje për të afruar shërbime audiovizuale, internet etj.

Në gjerdanin e bukur të bibliotekave të qytetit, vlen të nderojmë të gjithë punonjësit dhe stafet që kanë punuar në sektorët përkatës të të librit dhe periodikut, të materialeve

libra dhe jolibra, domosdosmërisht drejtorët e bibliotekave të Vlorës në vite: nga fillimet 1936-'44 e mbas Çlirimit: Rauf Zaimi, Ibrahim Kushta, Musa Muho e Mihal Peço; nga vitet '45-'47 Afërdita Thanasi; '47-'48 Jakup Gallanxhi; '48-'50 Valdete Gorishti; '50-'54 Tana Nesho; '54-'57 Fotini Jupi; '57-'64 Timo Vojniku; '64-'65 Irfan Bregu; '65-'68 Agron Grabova; '68-'91 Nezahet Braka; nga vitet 1991-2009 Liliana Gjika. Drejtues të bibliotekës së qytetit në vijim kanë qenë: shkrimtari Çlirim Hoxha, poetja Elma Rama dhe aktualisht ish - pedagogia e italishtes Iltana Koleka.

Emri i saj është përfshirë në enciklopedinë e qytetit "Vlora - fjalor enciklopedik", Tiranë, Maluka, 2023, f. 555-556, përgatitur nga prof. dr. Bardhosh Gajce.

Heroina e librit më '97 - ën

Ka ca realitete njeriu, që kur i kujton, thotë me vete: "Vërtet unë kam qenë, që kam mbajtur këtë qëndrim, që kam bërë këtë veprim? Vërtet...?"

Në rastin e këtij shkrimi të thjeshtë nderimtarie për Kllonçkën e shkrimtarëve, poetëve, artistëve dhe libërdashësve të shumtë vlonjatë, jemi në krahët epikë të pabesueshmërisë së trimërisë së përditësuar qytetare: Liliana Gjika është ajo kapetane shqiptare, që në mes të '97-ës, mori Bibliotekën e qytetit dhe, duke e parë plumbin drejt e në ballë, eci nëpër rrugët e Vlorës, të mbushura me plumba e gëzhoja dhe shpëtoi Bibliotekën hallemadhe të Vlorës sonë.

Në kohë lufte ata që ranë për liri u shpallën Dëshmorë të Atdheut. Ata që udhëhoqën me trimëri, atdhetarizëm dhe mençuri dhe u shquan për bëma të rralla u shpallën heronj të popullit. Liliana Gjika jetoi dhe punoi me devotshmëri, ndershmëri dhe profesionalizëm në kohë paqeje. Në fakt, që një segment kohor fatal, i zi, më keq se në kohë lufte. Ajo, për dritën e mendimit dhe veprimtari qytetar, është e vërteta Heroinë e Popullit (e gjallë). Është Kryezonja e Librit në qytetin e Pavarësisë Kombëtare. Kapetane bashkë me familjen e saj të mrekullueshme, me fëmijët, që i bëri pjesë të skuadrës së Shpëtimit të Librit, ku në ballë të zjarrit ishte bashkëshorti i saj shembullor, Viron Shamet Gjika, që për librat i qante zemra si për njerëzit më të afërm. Kemi përjetuar një realitet tej çdo lloj imaginate njerëzore, si në një ëndërr të zezë llahtarie. Vërtet një histori e pazakontë e një gruaje epike në kohë moderne, kohë që u infektuan aq keq e u hidhëruan aq shumë. Detashmenti i familjes Gjika, i muosën librat për t'i shpëtuar nga vandalizmat barbare të ca palo bashkëkohësve tanë të egër. Edhe pse kanë kaluar 27 vjet, nuk rrefehet pa drithërimë e pa lot në sy "Odiseja" e '97-ës, ajo ngjarje sa e rrezikshme aq e bukur, ajo histori aq frymëzuese e një mësuesje, e një shqiptarje të librit, kur, në një kohë shumë të trazuar për shqiptarët, Liliana bërë përpjekjet më heroike të mundshme për të shpëtuar librat; kreu atë akt të lartë, që mund të shkonte deri në sakrificën sublime të saj dhe familjes, që vuri në dispozicion të shpëtimit të kulturës shkrimore.

Modeli Lilianë. Shembull për njerëzit në Vlorë dhe në gjithë Shqipërinë. Unë, ne, bibliotekat e Vlorës qytetarët tanë të mirë, Atë e kanë në zemër, në shpirt, në sy, në mendje, sepse është NDERI I VLORËS... Qytetarët e njohin shumë mirë dhe e vlerësojnë shumë. Udhëtimi i saj në bibliotekë është Rrugëtimi i Nditur që ka bërë me Nder e Dinjitet. Dhe, në thjeshtësinë e saj bujare, në thelb, është ajo që shfaqet dhe ndihet krenare për atë që është. Për punën e saj, shkëlqimin e punës së specializuar e profesionale që ka bërë për 35 vjet në atë Bibliotekë, e cila ishte ndër bibliotekat më të mira në vend, ku janë kryer edhe shumë seminare nga rajoni etj., Liliana Lako Gjika është vlerësuar për ndihmesën e shquar në edukimin e brezave, si intelektuale e shquar e qytetit të Vlorës, e cila ka dhënë një ndihmesë të veçantë për zhvillimin e kulturës dhe traditave kombëtare. Ajo është se e meriton "Personalitet i Shquar i Qarkut Vlorë", titull që i është dhënë më 22.11.2012. Ajo është se e meriton "Mirënjohje e Qytetit". Edhe "Mirënjohje e Labërisë". Ajo është nderuar edhe me çmime e tituj të tjerë lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë, ku mund të përmend shumë çmime të tjera nga Ministria e Kulturës, 2 herë nga Ambasada Amerikane etj. Ajo është vlerësuar edhe me çmimin e lartë ndërkombëtar "Best Prektis", 2006. Ajo nuk kërkon, por meriton më shumë, se i bën dritë librit, i fal mirësi të bukur qytetarisë.

Urietur dashurisë

Nga Ndue Shabaku - Brescia

Tonaliteti intensiv i frymëzimit dhe ekzaltimi i heronjve nën pushtimin e ndjenjës, janë dy tipare dalluese të lizimit që përmban gjithë lënda e vëllimit poetik "Urietur dashurisë". Autori i këtij vëllimi Gjergj Nikolla, ka publikuar gjatë viteve disa vëllime me poezi lirike. Në poetikën e këtij vëllimi vërehet vazhdimësia dhe, falë maturimit, përvojës, mjeshtrisë së lartë e gjenialitetit të tij krijues, ngjitja në lartësi të admirueshme në fondin e lirikës më të arrirë moderne shqiptare. Lirika dallohet nga epika dhe dramatika për faktin që shpreh subjektivitetin e individit dhe është formati më i mirë për të përcuar ndjeshmërinë, mendimet, reflektimet e idetë në formë abstrakte e konceptuale. Këtij formati i përmbahen plotësisht lirikët dashurore të këtij vëllimi poetik, të shkruar me varg elektrolitik për dashurinë eletrizuese. Autori evokon ndjenjën si një forcë e padukshme, e cila përftohet përmes harkut elektrik, kur jonizohen, bien në kontakt dhe shkrihen zemrat përvëlimentare.

Subjekt, predikat, objekt, rrethanë; gjithçka është dashuria në poezitë dhe këngët lirike të këtij vëllimi. Lexuesi e ka të vështirë të dallojë që kjo ndjenjë është rezultat i unitetit të kundërtave, apo lidhje organike e përbërëse të së njëjtës frymë. Mozaikun e kësaj ndenje, autori e ndërton përmes lojës së dy heronjve lirikë. Ai dhe Ajo janë nën efektin e magnetikës, ndaj janë përherë në ferment, në lëvizje, në kërkim. Kur flaka e meteorit mbetet e ndezur, kahu i forcës tërheqëse është i diktuar; Ajo që me zërin e saj violinon për dashurinë e Ai që lëshohet si një stuhitar drejt saj. Sipas kredos së autorit të shprehur në vargun lirik, ndjenja e dashurisë është frymë, është gjallje, është motiv, është vetë jeta. Është kjo ndjenjë që provokon përjetime të skajshme nga vuajtjet paduruese deri tek gëzimi i papërmbajtur. Do të rrënoqthet lexuesi kur të ndiejë përpëlitjet e zemrës brenda kraharorit të heroit, të cilin e përplasim rrathëve të ferrit, kur mungon e dashuria. Nga ana tjetër, do të ngazëlletet, kur do të perceptojë në lirikën e këtij vëllimi poetik forcën transformuese të dashurisë, e cila lotët e një bote të gremisur i kthen ndritje të një tufe magjepëse rrezesh në botën e njeriut të dashuruar.

Autori është mjeshtrë i ndërtimit të kontrasteve të mëdha që shkakton tek njeriu ndjenja e dashurisë. Situatat në ferment hedhin heronjtë lirikë sa në gjysmësferën boreale, sa në gjysmësferën australe; sa në diell, sa në shi; sa në flakë, sa në hi... Gjithnjë autori motivon poetikisht faktin si ajo i sheshon të gjitha kontrastet dhe njeriu i dashuruar jeton vetëm një stinë, pranverën. Në pasazhet e poezive dhe të këngëve do të ndeshemi me bukuritë të rralla poetike, me hite për dashurinë, si këngë e gardelinës dhe e bilibilit, që të kundërtat rezultojnë si përbërës të të njëjtë komponent, si; eshka e stralli; vala e bregu; magma e llava; për ty zjarri, për të hiri, unë toka, ti stuhia; unë dallga, ti det me re; ... për të treguar se pasioni i ndjenjës së dashurisë i nënshtrohet ligjit të dialektikës, ndaj mbetet e ndezur gjithkund si flaka olimpikë. Në tejsfondin e poetikës së vëllimit është maskuar me mjeshtri e finesë një epizëm i lehtë, i cili e jep lirikës gjallëri e lëvizje. Dy heronjtë lirikë i gjen sa në brigje e kthina, maja e livadhe, aq në sythe e petale, në qelqe e ylberë, për të transmetuar herë ushtimën e herë përkëdheljen, herë furinë e herë delikatesën e ndjesisë. Në varg shfryjnë hove të forta shpirtit, përjetime intensive, lidhje të kristalizuara vetvetishëm dhe këto i japin dinamizëm të brendshëm sa veprimi e lojës së heronjve, aq edhe mendimit e përsiatjes. Rritja ekspozionale e adrenalines i bën heronjtë të shikojnë botën, mistershëm, nën një dritë krejt tjetër dhe lexuesi depërton me lehtësi në jetën që ngjet me një lëndinë.

Poeti, shkrimtari, eseisti, publicisti i talentuar Gjergj Nikolla ka profiluar e konsoliduar nga vepra në vepër individualitetin e tij artistik përmes një stili krejt të tijin. Niveli i gjerë kulturor, njohja e literaturës së hershme, klasike e moderne, zotërimi në gjerësi e thellësi i gjuhës shqipe, i japin bazën për t'u pozicionuar në pikëvështrimin e duhur të realitetit e dukurive shoqërore. Njohja e teorisë së letërsisë, i shkollave letrare botërore e shqiptare si dhe përvoja e gjatë krijuese e tij, kanë ndikuar dhe motivuar autorin e këtij vëllimi, që me veprën e tij të zërë një vend të dallueshëm në kreun letërsinë shqiptare. Autori ka meritën e madhe që në çdo vepër të evitojë përsëritjen e tij e t'i japë përmbajtjes format e zmalt të veçantë. Poezitë dhe këngët tërësisht lirike që prezantohen në librin e fundit, kanë të njëjtun numër vargësh e strofash ku ndihet fuqishëm tingëllimë dhe aromë ndenje e jete. Ashtu siç fsheh mesazhin piktori përmes nuancave të formës e ngjyrës, maskon poeti domethënien e poezisë përmes një gjuhe të rafinuar, përmes nuancave kuptimore të fjalëve, fjalëformimeve të përshtatshme. Ai



ka krijuar një numër të madh fjalësh që ruajnë orogjinalitetin e tij, duke emërtuar simbolikisht objekte e dukuri të natyrës e përjetimit, siç është edhe vetë titulli i këtij libri (Urietur dashu-

risë). Autori shpreh fantazinë krijuese përmes një figuracioni të pasur të natyrshëm letrar e sintaksor, në funksion të këngës pambarimtare të dashurisë.

Gjatë leximit do të hasim e do të ndalemi të ndiejmë ngacmimin e shumë figurave letrare të fjalëve e të mendimit, të sintaksës ... për të shijuar jo vetëm flakën e prushin e saj, por edhe butësinë e ëmbëlsinë. Dhe për të transmetuar ëmbëlsinë përmes vargut, autori shmang përdorimin e fjalëve të mëdha, retorikës së ngarkuar me efekte artificiale e ngjyime të theksura emocionale. Në këto krijime lirike do të hasim një gjuhë të pastër, me leksik të pasur, e cila na çon drejtpërdrejt në thelbin e poezisë.

Zakonisht, muzikantët përzgjedhin poezi të poetëve, për t'i përshatur në këngë. Për të përcjellë të ëmblën melodi, në këtë vëllim poeti Gjergj Nikolla ka përfshirë disa krijime me strofa e refren, të cilat janë tekste të mirëfillta këngësh, dedikuar dashurisë. Këta janë të destinuara për t'u dhënë jetë përmes tingujve. Me siguri, ndonjë kompozitor do të ndalet e do t'i përshkojë fjalët e këngëve në pentagram e do të stimulohen të sjellin melodi të reja. Kjo për faktin që autori i ka punuar me përkujdesje të veçantë, duke shkruar tekste që mbartin vlera të mirëfillta ideo-artistike. Poeti Gjergj Nikolla ka meritën se di të ndërthurë kaq bukur elementet ndjesore me elementet e natyrës dhe në përfaqje me të, na sjell portetin e dashurisë të sendërtuar.

Ky portret na mundëson që në borë e shi, stuhi e suferinë, të kemi diell në sy. Si e tillë, kjo ndjenjë të këndell, të merr në krahët e saj, të mbështell e mbërthen fort, sa nuk del dot. Përmes mozaikut e protretit, lojës dinamike të heronjve, hiteve e himneve për të, autori ka ditur t'i japë ndjenjës së dashurisë solemnitet përmes së thjeshtës, asaj që sjell e pranon çdo të mirë dhe që përjashton e zbon çdo të ligë, që shënon fundin e arratisë së shpirtit, që gjeneron njeriun e thjeshtë. Njeriun e dashuruar.

Università Pontificia Salesiana

FACOLTÀ DI LETTERE CRISTIANE E CLASSICHE

In una sintesi attenta al dialogo educativo e transculturale, la Facoltà unisce nel suo percorso formativo lo studio del mondo classico greco-romano e dell' *humanitas christiana*, rivolgendo particolare attenzione al mondo del lavoro e all'acquisizione di competenze specialistiche per la scuola, la ricerca, la gestione e valorizzazione del patrimonio e la promozione cristiana e culturale.

Programmi

- Baccalaureato | Laurea triennale
- Licenza | Laurea magistrale
- Indirizzi: Filologico-linguistico · Ermeneutico-letterario
- Dottorato

UN UMANESIMO PER EDUCARE IL FUTURO

Scopri il nostro **curriculum rinnovato** che unisce saggezza antica ed esigenze moderne, promuovendo oggi il dialogo di sempre tra cultura classica e fede cristiana. Il nostro programma offre un progetto educativo ben seguito, grazie alla competenza, alta dedizione e alla flessibilità di docenti attenti alla singolarità di ogni persona, con un taglio educativo unico.

Il **primo ciclo** accademico (Baccalaureato | Laurea triennale) insiste sull'acquisizione di ampie e approfondite competenze di base negli studi classici. Si dà spazio anzi a materie che avviano alle nuove metodologie ermeneutiche, in particolare nella prospettiva antropologica e degli studi storico-religiosi.

Il **secondo ciclo** (Licenza | Laurea magistrale) è volto ad impartire un'alta formazione specialistica mediante l'approfondimento di alcuni temi più ragguardevoli della classicità e della cultura del tardo antico (secc. I-III d.C.) e nei suoi successivi sviluppi. La didattica cura con particolare attenzione la prospettiva della transculturalità.

Prospettive professionali

Insegnamento Educazione Pedagogia motivazionale
Traduzione ed edizione di testi
Promozione, gestione e animazione culturale
Studio della complessità

Titolo di Licenza corrispondente ai fini del riconoscimento in Italia a LM-15 (DM MUR del 09.02.2024)

Per ulteriori informazioni lettere@unisa.it latinatas.unisa.it

Trovaci su YouTube bit.ly/4en3fMa

WINGS TRAVEL & Cargo



TRANSPORT NDERKOMBETAR Udhëtarë & Mallra
Bari, Foggia, Pescara, Ancona, Rimini, Bologna, Modenam, Parma, Piacenza, Milano, Bergamo, Brescia, Cremona

Autobus	+39 331 160 4572	Kamion	+39 324 551 7365
	+39 328 316 8617		+39 327 426 6040
	+39 327 426 6040		+355 69 337 3797
Shoferi	+355 68 545 0000		<i>Makina me qera</i>
			+355 69 337 3797

WINGS TRAVEL
Shqipëri - Itali - Shqipëri



WINGS TRAVEL

Bileta Avioni
Bileta Trageti
Bileta Autobuzi
Siguracione
Makina me qera

+355 69 337 3797
+355 68 840 8000
+39 331 1604572
+39 327 4266040
+39 328 316 8617

wingsagency@yahoo.com



Është për t'u lavdëruar gjesti bujar i shoferit të Kompanisë "Wings Travel & Cargo" Z. Hasan Nezaj, me origjinë nga Tropoja dhe banues në Durrës, i cili prej shumë kohësh nga Shqipëria për në Itali është një ndër shpërndarësit kryesor të gazetës "Rrënjët". Kur e pyet përse vallë gjithë ky përkushtim, me thjeshtësi të përgjigjet: "Ndjem krenar që kjo gazetë me frymë kombëtare e me emrin kuptimplotë "Rrënjët" të ndodhet në çdo familje shqiptare në mërgim.




BONI TRAVEL

SHQIPERI - ITALI - SHQIPERI

Administrator: Bilbil Çobaj
Shoferat

+355 692178389	+39 3444181239
+355 695222784	+39 3497447196

Adresa: VLORE - ALBANIA

Shoferit zemërbujar e patriot Bilibil Çobaj sapo i njoftuam mbi shpërndarjen e gazetës "Rrënjët" me thjeshtësi e buzëgaz na tha: "Është një nder e krenari për Kompaninë "Boni Travel" si dhe për mua personalisht që gazeta mbarëshqiptare të ndodhet në autobuzat e linjës: Arezzo, Bari, Brindisi, Firenze, Genova, Napoli, Pisa, Prato, Roma e Savona." Ai na premtoi që tashmë kjo gazetë me emrin kuptimplotë "Rrënjët" do të ndodhet kudo ku shkon "Boni Travel".

NOI srl
materiale edile

Shytermeja Aurel | Cell. 345 3029764
noi2017srl@libero.it

NOI s.r.l. - Via Anna Maria Mozzoni, 30
06073 Corciano, Perugia - Tel. 075 6979540 - P. IVA 03552250544

Nel punto di vendita NOI srl a Perugia, troverete un servizio professionale, speciale e tutti i materiali che cercate ..., ma di più troverete anche il nostro giornale "Le Radici". Il titolare, Shytermeja Aurel, è una persona eccellente che vi aspetta a braccia aperte.



Tek Smerald Shpk Vlore me President Mihal Selimaj do të gjeni llojshmëri materiale si: Pllaka të dimesioneve të ndryshme, paisje Hidrosanitare, Aksesorë, Tulla për Oxhak, Mozaik shumëngjyresh, Kol, Fino, Stuko..., por mbi të gjitha një shërbim të shpejtë, cilësor e me kulturë. Ju mirëpresim në ambjentet tona me shumëllojshmëri materiale sipas gustos dhe shijes suaj dhe me çmim të arsyeshëm.

Smerald Shpk Vlore

Adresa: Rruga Trasballkanike, pranë rrethrotullimit të Omones.
Magazina qëndrore në hyrje të Nartës.
Vlorë, Albania Tel: 00355/67202359 & 00355/682040290
FB : Smerald Shpk Vlore